

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

STRATEGJIA
KOMBËTARE PËR
ZHVILLIM DHE
INTEGRIM | 2015
2020

*Pjesë e Draftit të SKZHI
për konsultim Tematik*

— INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL —

Mars 2016

Vizioni 2020

“Shqipëria – një demokraci në forcim, në rrugën drejt integritit të saj në Bashkimin Evropian, me një ekonomi konkurruese, të stabilizuar dhe të qëndrueshme, që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut”

Shqipëria me një vështrim

TË PËRGJITHSHME	
Popullsia (INSTAT, 2015)	2,893,005
-% Meshkuj	50.5%
-% Femra	49.5%
-% Urbane	57.2 %
Shkalla mesatare e rritjes vjetore të popullsisë (2010-2015)	0.3%
Sipërfaqja	28,748 km ₂
Dendësia e popullsisë (2015, për km ₂)	106 / km ₂
Numri i bashkive	61
Monedha: Lek 1 dollar amerikan = 125.79lekë; 1 Euro = 137.28 lekë (31 dhjetor 2015 BSH)	
EKONOMIA	
Niveli i të ardhurave	Në nivelin e lartë të vendeve mesatare
PBB-ja aktuale në mln Lek (INSTAT, 2014)	1,400,549
PBB-ja për frymë US \$ (INSTAT, 2014)	4,587
Investimet e huaja të drejtpërdrejta, si % të PBB (INSTAT, 9 mujore 2014)	9,49 %
Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (qershor 2015)	1.4%
Deficiti i buxhetit si % e PBB (2015)	4 %
Borxhi Publik Bruto si % e PBB-së (2015)	72,2 %
NJERËZIT DHE SHOQËRIA	
Renditja sipas Indeksit të Zhvillimit Njerëzor (HDI, 2014)	85
Shkalla e punësimit, moshë 15-64 (INSTAT, Q3, 2015)	53.3 %
Raporti i shkallës së pjesëmarrjes femra/ meshkuj (2014)	72.5 %
Shkalla e papunësisë, moshë 15-64 (INSTAT, Q3, 2015)	17.2 %
Shkalla e papunësisë, moshë 15-29 (INSTAT, Q3, 2015)	32.3 %
Jetëgjatësia në lindje (INSTAT, 2014)	77.4
- Meshkuj	76.4
- Femra	80.3
Shkalla e alfabetizimit (mosha mbi 9 vjeç mund të lexojë dhe të shkruajë)	96.8%

Burimet: INSTAT, Banka Botërore, Index Mundi, ILO, UNDP

Akronime

BSh	Banka e Shqipërisë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
DDFFA	Departamenti për Zhvillim, Financim dhe Ndihmën e Huaj
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
KE	Komisioni Evropian
GJETNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
FDI	Investime të Huaja të Direkte
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrës Financiare
GS	Gaze serë
GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
HEC	Hidrocentral
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave (Instituti i Statistikave)
IPA	Instrumenti i Paraaderimit
GMIP	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
NjQV	Njësi e qeverisjes vendore
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PBA	Programi i Buxhetimit Afatmesëm
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NE	Ndihma Ekonomike
PKRE	Programi Kombëtar i Reformës Ekonomike
PKIE	Plani Kombëtar i Integritit Evropian
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RAP	Reforma e Administratës Publike
ShPLLf	Shpenzimet publike dhe llogaridhënia financiare
SMFP	Sistemi i Menaxhimit të Financave Publike
PIP	Program i Investimeve Publike
PPP	Partneriteti publik-privat
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociçim
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
EJL	Evropa Juglindore
SIGMA	Programi “Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit të Administratës”

KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
GSP	Grupet Sektoriale të Punës
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
ATP	Arsimi dhe trajnimi profesional
BB	Banka Botërore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
SEEC	Procesi i Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (South East European Cooperation Process)
CEI	Nisma e Evropës Qendrore (Central European Initiative)
MARRI	Nisma Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatet (Migration, Asylum, Refugees Regional Initiative)
SELEC	Qendra për Sundimin e Ligjit në Evropën Juglindore (Southeast European Law Enforcement Centre)
AII	Nisma Adriatiko-Joniane (Adriatic-Ionian Initiative)
BSEC	Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi (Black Sea Economic Cooperation)
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (Regional Cooperation Council)

11.0 SHTYLLA 3: INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL

Burimi më i rëndësishëm në Shqipëri janë burimet njerëzore dhe për rrjedhojë shoqëria dhe kultura e saj. Pikërisht në këto segmente të shtetit qëndrojnë të gjitha ato vlera themelore për lirinë, barazinë, mirëqënien dhe sigurinë e personit dhe pronës. Së bashku me sistemet e mirëqeverisjes, demokracisë dhe shtetit ligjor janë dimensionet njerëzore dhe sociale të Shqipërisë ato që qëndrojnë në themel të rritjes ekonomike.

Sic paraqitet në Figurën 31, Shqipëria ka pasur përgjithësisht një tendencë pozitive në lidhje me komponentët kryesorë të Treguesit të saj të Zhvillimit Njerëzor (TZHNJ) qysh nga viti 1980. Në vitin 2013, vlera e TZHNJ për Shqipërinë ishte 0.716 që sipas standardeve të PNUD-it e fut atë në “kategorinë e zhvillimit të lartë njerëzor”. Vendi u rendit në vendin 95 nga 187 vende dhe territore (dmth diku nga mesi). Qysh nga viti 1980, vlera e TZHNJ e Shqipërisë është rritur në 18.1% (nga 0.603 në 0.716), ose duke shënuar kështu një rritje vjetore prej afërsisht 0.52 përqind.


Për të ruajtur një rritje të qëndrueshme të zhvillimit njerëzor, mirëqënies dhe kohezionit social, SKZHI-II për periudhën 2015-2020 do të përqëndrohet në nëntë sektorë kryesorë që renditen më poshtë. Ndërsa sektorë si arsimit dhe shëndetësia zënë përqindjen më të madhe të burimeve të buxhetit kombëtar, sektorët e tjerë në kuadrin e Shtyllës 3 janë ata që qëndrojnë në themel të zhvillimit njerëzor dhe shoqëror në Shqipëri.

- **Arsimi**
- **Shëndetësia**
- **Punësimi**
- **Sigurimet shoqërore**
- **Menaxhimi migracionit**
- **Mbrojtja sociale**
- **Përfshirja sociale**
- **Barazia gjinore**
- **Arti dhe kultura**
- **Sportet**

11.1 Më shumë mundësi dhe më shumë cilësi në arsim

Sektori i arsimit mbulon nivelin para-universitar (arsimin fillor dhe të mesëm) dhe arsimin e lartë ose universitar. Sektori përfshin gjithashtu zhvillimin profesional të arsimtarëve dhe ndërtimin dhe ruajtjen e institucioneve dhe objekteve arsimore. Në këtë nën-seksion trajtohet si fillim arsimit në përgjithësi dhe sistemi i arsimit para-universitar në Shqipëri, dhe më pas paraqitet situata dhe objektivat që kanë të bëjnë në mënyrë specifike me arsimin e lartë.

Figura 31. Tendencat e treguesve TZHNJ në Shqipëri për vitet 1980-2013




Burimi: UNDP

■ Gjendja aktuale e sistemit arsimor në përgjithësi në Shqipëri.

Sistemi arsimor në Shqipëri, në tërësi, po përballë me një sërë sfidash të rëndësishme, pothuajse në të gjitha nivelet.¹ Së pari, bazuar mbi treguesit sasiorë dhe cilësorë të BE-së, reformat në sistemin arsimor **para-universitar** gjatë periudhës 2009-2013 nuk kanë sjellë ndonjë përmirësim të dukshëm në performancë. Ndonëse niveli i regjistrimit në institucionet e arsimit para-shkollor nuk arriti të siguronte regjistrimin e të gjithë fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç u shënuar gjithësesi një rritje nga 50% në vitin 2004 në 81 % deri në vitin 2014, siç ilustron Figura 32. Deri në vitin 2014, përqindjet e regjistrimit ishin më të larta për meshkujt (86.2% në krahasim me 75.2% për femrat).² Përqindjet e braktisjes së shkollës synuan të ishin drejt zeros (përqindja e braktisjes së shkollës në arsimin bazë në vitin 2009 ishte 0.46%, ndërsa në vitin 2012 ishte 0.39%).

Figura 32. Përqindjet e regjistrimit në arsimin parashkollor (grupmosha 3-5 vjeç) 2004-2014



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit/ INSTAT

Nivelet e regjistrimit në arsimin **e mesëm dhe sekondar** ishin gjithashtu nën mesataren, sipas treguesëve të BE-së. Regjistrimet për shkollën e mesme në periudhën 2011-2012 arritën 70.6%. Ministria kishte synim të ulte përqindjen e braktisjeve të shkollës së mesme në zero; megjithatë, përqindjet e braktisjes së shkollës në arsimin bazë në vitin 2009 ishin 0.46%, dhe pak më të ulta në vitin 2012, tek 0.39%. U bënë përpjekje për reformën e kurikulës në shkollat e mesme dhe universitare në vitin 2010, ndërsa për arsimin bazë në vitin 2013. Megjithatë, këto reforma nuk arritën të siguronin përmirësimet e pritshme në treguesit kryesorë, ndryshe nga performanca më pozitive e konstatuar në shumicën e vendeve të BE-së dhe OECD-së.

Gjatë viteve, qeveria ka bërë përpjekje për fuqizimin e **zhvillimit profesional të arsimtarëve**. Përpjekjet në përputhje me zbatimin e Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin e arsimit para-universitar" nuk sollën rezultate të ndjeshme përsa i takon përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe kjo mbetet ende një sfidë për të ardhmen. Kjo kryesisht për shkak të mungesës së vëmendjes së duhur për përcaktimin e nevojave për trainim të arsimtarëve dhe rrjedhimisht programet e trainimeve që u hartuan nuk përputheshin me nevojat reale.

Së fundi, gjendja përgjithësisht e dobët e **infrastrukturës fizike** së ndërtesave shkollore pengon ofrimin e një arsimit cilësor në të gjitha nivelet. Në rastin e fëmijëve me aftësi të kufizuara,

¹ Aktualisht nuk ka një strategji për sektorin e arsimit në tërësi.

² Gjithësesi këto nivele e kanë kaluar objektivin e Shqipërisë për OZHM-2 për vitin 2014, që ishte në 70%.

çështja nuk kufizohet vetëm dhe thjesht tek garantimi i aksesit fizik nga vetë shkollat, por përfshin edhe mbështetje shtesë (si p.sh. mbështetje financiare, shoqërore, transport etj.) për fëmijët dhe familjet e tyre (dhe ndërlidhjet përkatëse me programet e përfshirjes sociale).

■ **Sfidat.** Sfidat kryesore gjatë periudhës së planifikimit 2015-2020 janë të përqëndruara tek nevoja për: (1) rritjen dhe ruajtjen e niveleve të regjistrimit në nivelin para-universitar; (2) trajtimin e përfshirjes në mënyrë më proaktive, duke përfshirë politikat e hartuara jo vetëm për tërheqjen, por edhe për sigurimin e instrumenteve për të mbështetur dhe lehtësuar pjesëmarrjen e fëmijëve nga grupe vulnerabël dhe të përjashtuar nga pikëpamja sociale (si p.sh. vajzat, minoritetet, fëmijët me aftësi të kufizuara); (3) përmirësimin e kurikulës në përgjithësi, cilësisë së arsimit dhe cilësisë profesionale të arsimtarëve në të gjitha nivelet; dhe (4) trajtimin e mangësive në infrastrukturën dhe objektet arsimore.

■ **Vizioni.** “Një sistem arsimor që ka për bazë nevojat dhe interesat e nxënësve; që krijon kushtet dhe mundësitë për studentët për të ndërtuar dhe zhvilluar njohuritë e tyre, aftësitë dhe vlerat e kërkuara nga shoqëria; që lejon nxënësit të zhvillohen në mënyrë të pavarur dhe për të kontribuar për mirëqenien e tyre dhe të shoqërisë dhe në mënyrë konstruktive të përballen me sfidat e jetës”

■ **Objektivat strategjikë në arsimin para-universitar:**

1. Rritja e aksesit dhe regjistrimeve në arsimin para-universitar përmes:

- 1.1 Rritjes së numrit të regjistrimeve në klasat përgatitore (5-6 vjeç);
- 1.2 Ruajtjes së raportit midis numrit të nxënësve që mbarojnë arsimin bazë dhe atyre të arsimit të lartë;
- 1.3 Uljes së përqindjes së braktisjes së shkollës në arsimin bazë;
- 1.4 Zbatimit të politikave nxitëse për përthithjen e fëmijëve nga grupet vulnerabël.

2. Përmirësimi i shërbimit " Arsim cilësor për të gjithë" përmes:

- 2.1 Reformës së kurikulës së arsimit para-universitar të orientuar drejt kurikulave të bazuara tek kompetencat dhe arritjet e nxënësve;
- 2.2 Zhvillimit profesional të arsimtarëve dhe manaxherëve;
- 2.3 Ofrimit të shërbimeve psiko-sociale në çdo institucion arsimor para-universitar;
- 2.4 Zhvillimit të modeleve bashkëkohore të mësimdhënies, kombinuar me një rritje të përdorimit të teknologjisë;
- 2.5 Ngritjes së standardeve dhe instrumenteve për raportimin mbi cilësinë e shërbimit në shkolla; dhe
- 2.6 Azhurnimit dhe krijimit të infrastrukturës në kopshtet dhe shkollat e reja dhe ekzistuese, në përputhje me standardet evropiane, duke përfshirë aksesin për fëmijët me aftësi të kufizuara.

3. Përmirësimi i raportit të vendim-marrjes midis niveleve qendrore dhe vendore të institucioneve arsimore përmes:

- 3.1 Një vendim-marrjeje më efikase nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve në lidhje me hartimin e politikave arsimore, të vlerësimit dhe raportimit të cilësisë;
- 3.2 Mbështetjes më të madhe për autoritetet vendore për përmbushjen e detyrimeve dhe funksioneve të tyre juridike; dhe
- 3.3 Përmirësimit të kuadrit ligjor për mbështetjen e vendim-marrjes në shkolla.

4. Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit të burimeve financiare përmes:

- 4.1 Një nivel më të lartë mbështetjeje financiare për arsimin nga pushteti qendror dhe vendor për arsimin publik; dhe
- 4.2 Një skemë të përmirësuar financimi bazuar mbi numrin e nxënësve sipas parimit "paraja ndjek nxënësin" në të gjitha nivelet e vendim-marrjes.

■ **Gjendja aktuale e sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri.** Zhvillimet në sistemin e arsimit të lartë gjatë periudhës 2008 – 2013 në Shqipëri patën si synim rritjen e aksesit.³ Numri i nxënësve të regjistruar në institucionet e arsimit të lartë (IAL) u rrit me 60% nga 90,205 në vitin 2007 në 145,028 në periudhën 2013-14. Megjithatë, rritja e shifrave të frekuentimit të nxënësve nuk u shoqërua me rritjen në të njëjtat përmasa të personelit mësimdhënës apo me përmirësime infrastrukturore në institucionet e arsimit të lartë. Numri i pedagogëve në total u rrit me 32% në 3,651 deri në vitet 2013/14 nga 2,785 që kishte qenë në vitin 2007. Kjo ishte sa gjysma e rritjes së numrit të studentëve. Gjatë vitit akademik 2012-2013, 15.7% e studentëve të regjistruar në arsimin e lartë vinin nga shkollat e mesme profesionale. Gjatë vitit 2014-2015, përqindja e tyre u rrit me 16.3%, duke përfshirë ofruesit publikë dhe privatë (burimi, MMSR). Investimet në infrastrukturë në vitin 2013 për institucionet e arsimit të lartë (IAL) kapën shifrën 1.571 miliardë lekë, nga të cilat 643.4 milionë lekë nga buxheti i shtetit dhe 928.4 milionë lekë nga fondet publike të IAL-ve.

Ndonëse në vite janë krijuar një sërë standardesh, zgjerimi dhe zhvillimi i sektorit arsimor vijoi në mënyrë të fragmentarizuar. Pritej që një sektor kaq i madh sa arsimit, me rolin e tij kritik në zhvillimin e burimeve njerëzore të vendit të kërkonte një qasje më strategjike dhe të lidhur me nevojat e zhvillimit sektorial të vendit. Mungesa e një qasjeje strategjike për arsimin kontribuoi në një rënie të ndjeshme të cilësisë së arsimit të nivelit të lartë.

Në rastin më të mirë monitorimi ka qenë thjesht formalitet. Asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë në lidhje me konstatimet dhe rekomandimet, duke sjellë një përkeqësim të mëtejshëm të gjendjes së përgjithshme. Për më tepër, kurikula përfitoi nga vlerësime apo akreditime të jashtme gjë që gjithashtu konsiderohet të ketë ndikuar në rënien e cilësisë. Gjithashtu kurikulës nuk iu bënë vlerësime apo akreditime të jashtme, gjë e cila po ashtu konsiderohet të ketë ndikuar në cilësinë në rënie. Në këto kushte, 44 IAL private dhe 15 IAL publike nuk arritën të përmbushnin kriteret minimale, sipas përcaktimit në ligjin për arsimin e lartë. Për më tepër, kurikula nuk është e harmonizuar aq sa duhet në rang kombëtar.

³ "Strategjia e zhvillimit të arsimit parauniversitar, për periudhën 2014-2020" është miratuar me VKM Nr.11, datë 11.1.2016.

■ **Sfidat.** Sfidat kryesore të arsimit të lartë përfshijnë nevojën për: (1) rritjen e cilësisë përmes përmirësimit të kushteve të mësimdhënies; (2) rritjen e numrit dhe cilësisë së personelit; (3) përmirësimin e infrastrukturës; (4) azhurnimin e kurikulës dhe standardeve cilësore, në përputhje me standardet më të mira evropiane; (5) sigurimin e përputhshmërisë së strategjive, kurikulave dhe programeve të arsimit me ato të sektorit privat dhe për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës; (6) zgjerimin e arsimit post-sekondar në përputhje me nevojat e fushave specifike dhe zhvillimet rajonale; (7) forcimin e kapaciteteve të përgjithshme institucionale; dhe (8) rritjen e autonomisë dhe vetë-qeverisjes së IAL-ve.

■ **Objektivat strategjikë**

1. Rritja e cilësisë së arsimit të lartë përmes:

- 1.1 Rritjes së përqëndrimit në lidhje me përmirësimin e kushteve të mësimdhënies në të gjithë elementët përbërës të saj (personeli, infrastruktura etj);
- 1.2 Zbatimit të reformës së arsimit të mesëm, duke përfshirë hartimin dhe miratimin e një ligji të ri dhe bazës nën-ligjore, që çon në krijimin e agjencive të reja të përfshira në skemën e arsimit të lartë;
- 1.3 Forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve të tjera përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve;
- 1.4 Përmirësimit të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë përmes akreditimit të IAL-ve publike dhe private dhe programeve studimore; dhe
- 1.5 Përmirësimeve përkatëse në kuadrin ligjor, në përputhje me standardet e BE-së.

2. Mbështetja dhe shtimi i programeve studimore që kanë si synim përmbushjen e nevojave të tregut të punës përmes:

- 2.1 Ristrukturimit të të gjitha programeve studimore, sipas ligjit të ri dhe praktikave më të mira evropiane në fushat përkatëse, si edhe në përputhje me direktivat evropiane për profesionet e rregulluara dhe direktivat e tjera për programet specifike studimore;
- 2.2 Zbatimit dhe përshtatjes së Kuadrit shqiptar të kualifikimit me Kuadrin Evropian të Kualifikimit dhe direktivat e BE-së, duke përfshirë hartimin e kuadrit sektorial; dhe
- 2.3 Ofrimit të programeve cilësore studimore, sipas përvojave më të mira të BE-së që do të çojnë në njohjen e diplomave të arsimit të lartë të marra në Shqipëri, si edhe në njohjen e kualifikimeve nga BE-ja që do të bëjnë të mundur punësimin e specialistëve shqiptarë në vendet e BE-së.

3. Sigurimi i një arsimi profesional që i korespondon nevojave të fushave specifike dhe zhvillimeve të rajoneve specifike përmes:

- 3.1 Profilizmit dhe diferencimit të IAL-ve për t’iu përgjigjur më mirë nevojave të tregut të punës, nevojave të zhvillimit kombëtar dhe rajonal dhe procesit të integritimit në BE;
- 3.2 Mbështetjes më cilësore për universitetet publike përmes Fondit të Zhvillimit Strategjik, me qëllim ofrimin e programeve të studimeve profesionale;
- 3.3 Krijimit të kushteve dhe bazës ligjore për monitorimin e treguesëve të punësimit; dhe
- 3.4 Përmirësimit të bashkëpunimit midis IAL-ve dhe sektorëve të manufakturës dhe shërbimeve.

4. Rritja e autonomisë dhe vetëqeverisjes së IAL-ve përmes:

- 4.1 Përkufizimit të qartë dhe forcimit të statusit juridik të IAL-ve, duke përfshirë ristrukturimin organizativ dhe rritjen e efikasitetit dhe autonomisë institucionale;
- 4.2 Rritjes së përgjegjshmërisë, eficiencës së manaxhimit dhe kapaciteteve të përgjithshme të strukturave të IAL-ve, për t'iu përgjigjur më mirë publikut, sipas parimeve të autonomisë, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë;
- 4.3 Përfshirjes më të madhe të trupës akademike dhe nxënësve në proçeset e vendim-marrjes;
- 4.4 Më shumë autonomi financiare për universitetet, bazuar mbi rezultatet dhe numrin e nxënësve, me anë të një formule të re financimi;
- 4.5 Një rritjeje të fondeve publike për arsimin e lartë, deri në vitin 2020;
- 4.6 Krijimit të sistemeve dhe procedurave për të siguruar mbështetje financiare për nxënësit bazuar mbi rezultatet shkollore dhe rrethanat e tyre shoqërore; dhe
- 4.7 Ngritjes së një Fondi të Zhvillimit Strategjik (grant konkures) si instrument për politikat e arsimit të lartë, zhvillimin e infrastrukturës universitare, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.


5. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë dhe rritja e kontributit të “Albanian excellence” në tregun e punës përmes:

- 5.1 Fuqizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar midis institucioneve të arsimit të lartë dhe rritjes së nivelit të pjesëmarrjes në programet shkencore, kërkimore dhe programet e përbashkëta të BE-së;
- 5.2 Krijimit të një rrjeti të “Albanian excellence” që jeton jashtë shtetit, me qëllim rritjen e kontributit të tyre përmes kthimit të tyre definitiv apo jo në Shqipëri (dmth shndërrimin e të ashtu-quajturit “Brain Gain” në “Brain Circulation”);
- 5.3 Rritjes së lëvizjes së studentëve, pedagogëve dhe shkencëtarëve për shkëmbimin e “përvojave më të mira” midis institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe jashtë saj, me një kontribut më të madh në fushat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;
- 5.4 Reformës së Fondit të Ekselencës, i cili siguron financime jo vetëm për studentët, por edhe për administratën shtetërore;
- 5.5 Rritjes së aplikimeve direkte individuale të studentëve dhe profesionistëve shqiptarë në institucionet më të mira të arsimit të lartë mbështetur me fonde përmes a një zyre të dedikuar asistence që siguron marrëdhëniet e tyre me institucionet përkatëse; dhe
- 5.6 Përfitimet nga programet e BE-së, përmes ERASMUS +, programeve arsimore të BE-së, që kanë si synim modernizimin e sistemeve arsimore dhe përshtatjen e tyre për nevojat e tregut të punës dhe botës në ndryshim.

11.2 Një sistem i kujdesit shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm

■ **Gjendja aktuale.** Sipas standardeve rajonale, shqiptarët janë të shëndetshëm, por vendit i duhet të trajtojë barrën në ndryshim të sëmundjeve, si dhe risqet në rritje që i kanosen shëndetit të popullatës.⁴ Mesatarja e jetesës në lindje ka arritur afërsisht 77.4 vjeç (deri në vitin 2014). Ky nivel relativisht i lartë mund të shpjegohet me dietën ushqimore përgjithësisht të shëndetshme mesdhetare të shqiptarëve. Një tregues kryesor matës i sistemit shëndetësor është incidenca e vdekshmërisë foshnjore për 1000 lindje të gjalla, i cili në Shqipëri ka rënë nga 17.5 në vitin 2002 në 7.9 në vitin 2014, siç ilustron në figurën 33 dhe është nën objektivin e OZHM-ve prej 8.0. Megjithatë, përllogaritjet e vdekshmërisë

Figura 33. Vdekshmëria foshnjore për 1000 lindje të gjalla, 2002-2014



Burimi: MSH / INSTAT

foshnjore të botuara nga OBSH-ja flasin për një diferencë të ndjeshme midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit si: Bosnje- Hercegovina (në 5.8 për 1000 lindje të gjalla), Mali i Zi (në 5.5 për 1000 lindje të gjalla), Serbia (në 5.7 për 1000 lindje të gjalla) dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (në 6.5 për 1000 lindje të gjalla).⁵

Në përgjithësi, sëmundjet jo- të transmetueshme dominojnë barrën e sëmundshmërisë: sëmundjet e zemrës, infeksionet e traktit të ulët të frymëmarrjes dhe kanceri i mushkërive janë shkaqet kryesore të vdekjeve të parakohëshme. Zakonet ushqimore të popullsisë shqiptare po ndryshojnë. Profili Global i Barrës së Sëmundjeve për vitin 2010 citon mënyrën e të ushqyerit si faktorin kryesor të riskut në Shqipëri, duke ia kaluar tensionit të lartë dhe duhanpirjes. Sipas Sondazhit Demografik të Shëndetit për vitin 2009, përqindja e duhanpirjes mes popullatës së rritur shqiptare është konstatuar tek 38%.⁶

Një tjetër sfidë që ka lidhje me shëndetësinë është prevalenca e sëmundjeve kronike. Sëmundjet jo të transmetueshme kërkojnë trajtim të zgjatur dhe të kushtueshëm, si edhe kujdes profilaktik. Sistemit aktual të shëndetësisë i mungojnë mundësitë për trajtimin e të gjithave. Ulja e çmimit të barnave, të cilat shpesh janë më të larta se në vendet e tjera të BE-së është një ndër këto aspekte që duhet marrë në konsideratë, duke përfshirë edhe nevojën e zgjerimit të shërbimeve farmaceutike në zonat rurale.


⁴ "Startegjia Kombëtare e Sektorit të Shëndetësisë 2016-2020" është duke u hartuar.

⁵ Banka Botërore ; Raporti nr. 82013.

⁶ Treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit të OKB-së.

Ky është në veçanti rasti i përqindjes së prevalencës së HIV-it tek të rriturit, e cila ka ardhur në rritje të ndjeshme gjatë viteve të fundit, siç edhe tregohet në figurën 34, ku sipas përlllogaritjeve në vitin 2015 u regjistruan 869 raste.

Figura 34. Përqindja e prevalencës së rasteve të personave të prekur me HIV tek të rriturit, 2002-2014



Burimi: MSH

Kujdesi spitalor në Shqipëri është kryesisht publik, por shërbimet ambulatorë dhe farmacitë private janë gjithashtu të përhapura gjerësisht. Ka më shumë se 400 objekte të shëndetit parësor. Shpenzimet spitalore përbëjnë afërsisht 55% të të gjithë buxhetit të shëndetësisë.⁷ Praktikisht, pacientët i anashkalojnë shpesh shërbimet e shëndetit parësor dhe dytësor të referencës, për shkak të cilësisë së dobët të perceptuar që ofrohet në to. Ndonëse janë shpenzuar mbi 500 milionë lekë për rindërtimin, ndërtimin dhe pajisjen e qendrave të kujdesit shëndetësor, ato ende shfaqen me mangësi serioze në infrastrukturë dhe kushtet higjieno-sanitare, si edhe në pajisje. Kjo i ka detyruar njerëzit t'i plotësojnë nevojat e tyre të nivelit të lartë për shërbime shëndetësore nga poliklinikat dhe spitalet. Kjo sjell ulje të efikasitetit të sistemit dhe rëndon në "kurriz" të buxheteve familjare. Ofrimi nga privati i kujdesit parësor dhe ambulator është i përhapur dhe përfshin shërbimet private që ofrohen nga ofrues publikë të praktikës së dyfishtë. Kujdesi shëndetësor dytësor dhe tretësor është i kufizuar, ndaj edhe afërsisht 70% e shqiptarve përdorin zakonisht sistemin shëndetësor publik.

Në vitin 2013, **sistemit i kontributit shëndetësor** në Shqipëri mbulonte më pak se gjysmën e popullatës aktive. Afërsisht 1 milionë shqiptarë në moshë pune i mbulojnë vetë kostot shëndetësore dhe afërsisht 60% e shpenzimeve familjare për shëndetësinë janë pagesa nga xhepi në pikën e marrjes së shërbimit.⁸ Primet e sigurimeve nuk janë në përputhje me nivelin e të ardhurave, gjë që do të thotë se personat pagat e të cilëve janë në nivelin e lartë të shkallës së të ardhurave kontribuojnë më pak në terma relative sesa personat që janë në nivelin e ulët të shkallës së të

Sa të kënaqur janë njerëzit nga shërbimi shëndetësor. . .

"Në përgjithësi shqiptarët nuk janë të kënaqur as me cilësinë dhe as me efikasitetin e shërbimeve publike shëndetësore. Vetëm 45 përqind e tyre shprehen të kënaqur—duke përbërë përqindjen më të ulët mes vendeve të rajonit . Bosnje- Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi e kanë këtë nivel së paku tek 55%. I njëjti sondazh ka treguar edhe arësyet e mundshme (përvec cilësisë dhe efikasitetit) për këtë pakënaqësi nga ana e shqiptarëve: 39 përqind e personave të anketuar u përgjigjën se zakonisht duhen bërë pagesa nga xhepi për të marrë shërbimin në sistemin publik. Kjo jo vetëm është përqindja më e lartë në rajon, por përfaqëson gjithashtu dyfishin e atyre personave të anketuar për të njëjtin sondazh të cilët u shprehën se duhet të bëjnë pagesa informale për të pasur mundësi të përfitojnë nga shërbimet publike në përgjithësi, në Shqipëri"

⁷ Nga të dhënat e HIF-it.

⁸ <http://data.euro.who.int/hfad/>.

ardhurave. Rrjedhimisht, skema e sigurimeve shihet si jo-progresive dhe si e tillë kontribuuese në padrejtësitë shoqërore.

Mbulimi nga sigurimet nuk duket të ketë ndonjë ndikim të ndjeshëm në uljen e shpenzimeve nga xhepi për shëndetësinë.⁹ Shpenzimet nga xhepi për shëndetësinë janë më të larta për personat e siguruar, sesa për personat që nuk janë të siguruar. Ndërsa kjo mund të reflektojë faktin që personat e siguruar janë më të pasur, njëkohësisht ngre pikëpyetje mbi efikasitetin e skemës aktuale të sigurimeve. Konsumi mesatar familjar për frymë është afërsisht 13 përqind më i lartë për personat e siguruar. Sipas së njëjtës logjikë, personat e siguruar shpenzojnë sa dyfishi i personave që nuk janë të siguruar për barnat pa recetë, 80% më shumë për barnat me recetë, dhe pothuajse 70% më shumë për shpenzimet shëndetësore OOP në përgjithësi. Ndërsa këto shifra duhen marrë me rezervë, ato shprehin qartazi shqetësime në lidhje me efikasitetin e mbrojtjes financiare që ofrohet nga sistemi aktual. Ato gjithashtu sugjerojnë se përmirësimi i efikasitetit të mbulimit duhet të ketë prioritete, përpara se të bëhen shpenzime substanciale publike për rritjen e mëtejshme të mbulesës, sidomos për personat që nuk janë të varfër. Nivelet e larta të shpenzimeve nga pacientët e siguruar për barnat me recetë – edhe ndonëse këto duhen financuar nga sigurimet – nuk bëjnë gjë tjetër veçse e theksojnë rëndësinë e tyre.

Së fundi, **Shërbimi i Urgjencës** po përballlet me vështirësi për shkak të një sërë faktorësh: (1) mungesa e organizimit territorial ka sjellë vonesë në reagimin e urgjencës; (2) shërbimit të urgjencës i mungojnë pajisjet e përshtashme për të shpëtuar jetë dhe pajisjet lënë për të dëshiruar; dhe (3) personelit të urgjencës iu mungon kualifikimi i duhur. Këta faktorë kanë kontribuar në vdekjet e mijëra pacientëve, vdekje të cilat mund të ishin shmangur. Në përgjithësi, spitaleve iu mungojnë procedurat dhe protokollat standarde të punës, gjë që ka sjellë si pasojë rritjen e abuzimit apo shpërdorimit me barnat dhe pajisjet mjeksore. Mungojnë sistemet dhe standardet e monitorimit (akreditimit) për cilësinë e shërbimit shëndetësor. Treguesit e informacionit shëndetësor dhe ato të kujdesit shëndetësor në nivel individual dhe kombëtar në përgjithësi mungojnë, janë të pamjaftueshëm, të pasaktë apo të fragmentarizuar.

■ **Sfidat.** Shqipëria përballlet me sfida të mëdha për sa i takon kujdesit të duhur dhe cilësor shëndetësor. Qeveria shqiptare ka propozuar një lëvizje drejt mbulesës së kujdesit shëndetësor universal që do të financohet nga të ardhurat e përgjithshme, por rradha dhe implikimet fiskale të këtij tranzicioni duhet të jenë të menduara me kujdes. Reforma e propozuar përfshin dy elementë kryesorë: (1) një kalim gradual nga modeli aktual hibrid i financimit të shërbimit publik përmes primeve të sigurimeve të pagave nga borderotë dhe të ardhurat e përgjithshme drejt një modeli të financuar vetëm nga të ardhurat e përgjithshme; (2) zgjerimi i gamës dhe thellësisë së mbulesës shëndetësore për të gjithë popullatën; dhe (3) përfundimi dhe miratimi i “*Strategjisë së shëndetësisë, 2016-2020*” brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2016”. Gjithashtu, mbulesa universale në shëndetësi ka disa dimensione, duke përfshirë përqindjen e popullësisë që

⁹ Referenca tek Raporti i Bankës Botërore:
<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/20442/820130v2GRAY0COVER0Box385323B00PUBLIC0.pdf?sequence=1>.

mbulohet nga sigurimet, përqindjen e kostove që mbulohen dhe numrin e shërbimeve të mbuluara.

Në transformimin e sistemit të kujdesit shëndetësor ekziston nevoja për një integrim dhe koordinim më të mirë me programet e mbrojtjes shoqërore, sigurisë në vendin e punës, mbrojtjes së mjedisit, politikat për sportet, planifikimit territorial dhe rregulloret e politikave. Me buxhete të kufizuara, edhe përparësitë duhet të jenë të qarta, duke u përqëndruar tek çështjet madhore të shëndetësisë, si: përdorimi i drogës, abuzimi me alokoholin, duhanpirja, siguria rrugore, siguria ushqimore dhe kequshqyerja, sëmundjet e reja infektive dhe sëmundjet e neglizhuara, manaxhimit strategjik i kimikateve dhe faktorët mjedisorë. Ndaj edhe lind nevoja për një Shërbim Kombëtar Urgjence që do të ofronte një reagim të shpejtë dhe profesional ndaj nevojave të shëndetësisë bazuar mbi standarde të barabarta dhe të prështatshme sipas nevojave sezonale për kujdes në rastet e sëmundjeve dhe traumave.

■ **Vizioni.** *“Kujdes shëndetësor universal cilësor dhe në kohë për të gjithë personat që banojnë në Shqipëri”*

Vizioni për kujdesin shëndetësor në Shqipëri mund të shihet me krijimin e një sistemi me infrastrukturë të modernizuar dhe më rritjen e sigurisë. Spitalet publike nuk do të jenë vetëm vende ku njerëzit marrin trajtim mjekësor, por edhe qendra ku do të tregohet solidariteti dhe kultura sociale. Sistemi shëndetësor do të bazohet mbi protokolle të sakta dhe shkencore, si edhe procedura standarde, si elementë kryesorë të transparencës, verifikueshmërisë, përgjegjshmërisë, përgjegjësisë dhe cilësisë së shërbimit spitalor. Do të krijohen parimet e qeverisjes klinike në spitale, me standarde të larta të kujdesit shëndetësor, shërbime efikase, transparencë dhe përgjegjshmëri dhe me vëmendje drejt personave më vulnerabël. Pagesat spitalore do të ndryshojnë sipas kostove dhe grupeve sipas diagnozave (DRG). Spitalet publike dhe ato private do të akreditohen dhe do të jenë objekt ri-vlerësimesh të vazhdueshme.

■ **Objektivat strategjikë**

1. **Përmirësimi i cilësisë së kujdesit shëndetësor, duke garantuar akses të plotë për të gjithë personat që jetojnë në Shqipëri, sipas një sistemi të qendrueshëm financiar përmes:**
 - 1.1 Krijimit të një shërbimi shëndetësor kombëtar dhe profesional, i cili përmbush nevojat e popullatës në të gjitha krahinat e vendit;
 - 1.2 Ngritjes dhe zbatimit të standardeve të barabarta në të gjitha qendrat shëndetësore, për t’iu përgjigjur ndryshimeve klimaterike;
 - 1.3 Vendosijes së objektivit të depistimit të hershëm për persona të grupmoshës 40-65 vjeç për diabetin, vlerësimin me teknologji shëndetësore (HTA), kancerin kolorektal, stresin dhe depresionin;
 - 1.4 Azhurnimit të regjitrave të shtetasve të depistuar;
 - 1.5 Ngritjes së Shërbimit Kombëtar të Urgjencës;
 - 1.6 Përmirësimin të shërbimit shëndetësor përmes zgjerimit progresiv të listës së barnave të rimbursueshme; dhe

1.7 Zhvillimit të modeleve financiare për kujdesin shëndetësor në nivel parësor, dytësor dhe tretësor përmes Fondit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.

2. Rritjes së numrit të viteve të shëndetshëm të jetës së popullësisë shqiptare përmes:

- 2.1 Nxitjes së rolit të shëndetit publik dhe programeve parandaluese dhe promovimit shëndetësor;
- 2.2 Uljes së përqindjes së vdekshmërisë foshnjore;
- 2.3 Uljes së përqindjes së vdekshmërisë amtare;
- 2.4 Rritjes së numrit të testeve dhe konsultimeve në Qendrat e Testimit dhe Këshillimit për HIV/SIDA;
- 2.5 Fuqizimit të shërbimeve shëndetësore dhe sistemeve ndër-sektoriale, për t'iu përgjigjur më mirë ndryshimeve klimaterike; dhe
- 2.6 Rritjes së ndërgjegjësimit dhe qëndrimit në përgjithësi në lidhje me shëndetin.

3. Modernizimi i infrastrukturës dhe rritja e sigurisë dhe cilësisë së kujdesit spitalor përmes:

- 3.1 Rindërtimit apo rehabilitimit të objekteve të dëmtuara apo objekteve spitalore të projektuara dobët;
- 3.2 Rritjes së disponueshmërisë së pajisjeve diagnostikuese në spitalet rajonale;
- 3.3 Decentralizimit të shërbimeve spitalore që lidhen me sëmundjet me incidencë të lartë vdekshmërie nga shkaqe si: tumoret dhe sëmundjet kardiovaskulare në spitalet e Durrësit, Vlorës dhe Shkodrës;
- 3.4 Hartimit dhe zbatimit të saktë dhe shkencor të protokolleve dhe procedurave standarde;
- 3.5 Ofrimit të kujdesit shëndetësor spitalor përmes mekanizmave të përmirësuara financiare, rritjes së autonomisë dhe standardeve të mirë-përpilura;
- 3.6 Rritjes së kapaciteteve dhe kompetencave të mjekve dhe infermiereve përmes përdorimit të teknikave të reja dhe praktikave diagnostikuese;
- 3.7 Vlerësimit të performancës së personelit mjekësor përmes sistemit të azhurnuar të akreditimit;
- 3.8 Vendosjes së parimeve të qeverisjes klinike që kanë si synim arritjen e standardeve të larta të kujdesit shëndetësor, shërbimeve efektive, transparencës dhe përgjegjshmërisë;
- 3.9 Administrimit më efikas dhe financimit të spitaleve, sipas paketave të shërbimeve individuale të kontraktuara;
- 3.10 Kontraktimit të shërbimeve të sterilizimit të sallave të operacioneve në të gjithë vendin;
- 3.11 Ndërtimit të modeleve të partneritetit publik-privat, për të siguruar manaxhimin më me efikasitet të kohës, materialeve dhe burimeve financiare; dhe
- 3.12 Ngritjes dhe zhvillimit të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor në nivel kombëtar.

4. Rritja e cilësisë dhe sigurisë së barnave, në përputhje me standardet europiane përmes:

- 4.1 Uljes së çmimit të shitjes së barnave në Shqipëri;
- 4.2 Rritjes së kontrollit të cilësisë gjatë fazës së shpërndarjes së barnave;
- 4.3 Disponueshmërisë së një shërbimi cilësor farmaceutik në të gjithë vendin;
- 4.4 Krijimit të një sistemi ndjekjeje; dhe
- 4.5 Krijimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjeksore.

5. Zhvillimi i një qasjeje të integruar dhe më të mirë koordinuar të kujdesit shëndetësor përmes:

- 5.1 Zhvillimit të mekanizmave të bashkërendimit ndër-sektorial për çështjet madhore të shëndetësisë që kanë të bëjnë me përdorimin e drogave, abuzimin me alkooholin, duhanpirjen, sigurinë rrugore dhe keqshqyerjen, sëmundjet infektive, manaxhimin strategjik të kimikateve, mbrojtjen e fëmijëve, referimin e rasteve dhe problemet që lidhen me dhunën në familje;
- 5.2 Vaksinit në kohë të fëmijëve, sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit;
- 5.3 Uljes së synuar të numrit të epidemive që përhapen përmes ndotjes së ujit;
- 5.4 Zhvillimit të mekanizmave të bashkërendimit për personat me aftësi të kufizuar, gjë që do të mundësojë integrimin e tyre në jetën shoqërore;
- 5.5 Rritjes së monitorimit të agjencive mjedisore; dhe
- 5.6 Rritjes së numrit të laboratorëve të pajisur me pajisjet që nevojiten për të evidentuar shkaqet e sëmundjeve me origjinë ushqimore.

6. Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë dhe rikthimi i besimit të publikut të gjerë në sistemin e kujdesit shëndetësor përmes:

- 6.1 Hartimit dhe zbatimit të Strategjisë së Shëndetësisë për periudhën 2016-2020;
- 6.2 Krijimit të një sistemi informacioni të automatizuar të kujdesit shëndetësor që do të lidhë të gjithë aktorët publikë dhe privatë brenda sistemit shëndetësor në tërësi;
- 6.3 Krijimit dhe azhurnimit rutinë të regjistrave të sëmundjeve; dhe
- 6.4 Zbatimit periodik të Llogarive Kombëtare të Shëndetësisë.

11.3 Shtimi i mundësive të punësimit

■ **Situata aktuale. Tregu i punës** në Shqipëri ka vijuar ndryshimet dhe përshtatjet ndaj kushteve të tregut, por jo me shpejtësinë dhe fleksibilitetin e duhur. Së pari, tregu i punës ende dominohet nga veprimtaria e sektorit privat bujqësor që përbën 43% të gjithë punësimit në rang

Tablela 3. Tendencat e papunësisë dhe punësimit në Shqipëri, 2007-2014

Unemployment	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Age group 15-29	19.8	24.7	21.9	22.5	21.9	26.0	27.2	32.5
Age group 30-64	10.7	10.0	10.4	10.8	11.1	10.0	13.1	13.3
Age group 15-64	13.5	13.2	13.8	14.2	14.3	13.8	16.4	17.9
Age group 15+	13.4	13.1	13.8	14.0	14.0	13.4	15.9	17.5
Employment according to Sector	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Employed (I+II+III)	939,000	901,708	905,088	904,210	925,242	959,227	916,916	925,262
I. Public sector	167,100	166,543	166,430	166,338	165,100	164,400	163,900	163,885
%	17.8%	18.5%	18.4%	18.4%	17.8%	17.1%	17.9%	17.7%
Budgetary	125,200	125,500	125,320	126,500	128,200	128,734	129,212	129,065
%	13.3%	13.92%	13.85%	13.99%	13.86%	13.42%	14.09%	13.95%
Non-budgetary	41,900	41,043	41,110	39,838	36,900	35,666	34,688	34,820
%	4.5%	4.6%	4.5%	4.4%	4.0%	3.7%	3.8%	3.8%
II. Non agricultural private sector	229,900	238,975	237,231	241,836	256,288	268,690	290,763	318,571
%	24.48%	26.5%	26.2%	26.7%	27.7%	28.0%	31.7%	34.4%
III. Agricultural private sector	542,000	496,190	501,427	496,036	503,854	526,137	462,253	442,806
%	57.7%	55.0%	55.4%	54.9%	54.5%	54.9%	50.4%	47.9%

kombëtar.¹⁰ Së dyti, proporcionet e krahut të punës në industri (17.4%) dhe shërbime (39.4%) janë shumë më poshtë nga vendet e tjera të Evropës Juglindore dhe BE-së. Së treti, përsa i takon pjesëmarrjes në krahun e punës, niveli i punësimit për popullatën e moshës nga 15-64 vjeç ka shënuar rënie nga 55.9% në vitin 2012 në 52.1% në fillim të vitit 2015. Në tabelën e mëposhtme përshkruhen tendencat e punësimit dhe papunësisë në Shqipëri gjatë periudhës 2007 – 2014.

Punësimi në sektorin privat. Sektori privat ka qenë gjithmonë burimi më i madh i sigurimit të vendeve të punës dhe punësimit në Shqipëri gjatë shtatë viteve të shkuar, me mbi 80% të krahut të punës të punësuar në këtë sektor. Programet qeveritare kanë mbështetur rritjen ekonomike të sektorit privat, që shihet si e rëndësishme për qendrushmërinë afatgjatë të këtij sektori dhe krahut të tij të punës. Bazuar mbi të dhënat e punësimit, sektori jo-bujqësor privat ka ardhur në ekspansion të vazhdueshëm, teksa ekonomia lëviz drejt veprimtarive më produktive në shërbime dhe nën-sektorët e industrisë, në kombinim me proceset e urbanizimit. Këto përpajime janë bërë të mundura nga zgjerimi i punëve që lidhen me shërbimet (komunikimi, teknologjia e informacionit, restorantet dhe hotelet etj.), industrinë e lehtë dhe industritë nxjerrëse etj. Zgjerimi i niveleve të punësimit në tregje të reja për sektorin privat do të kërkojë politika proaktive për rritjen e konkurrueshmërisë, investimet e huaja direkte, trainime, përdorimin e informacionit dhe teknologjive të komunikacionit, përdorimin me efikasitet të burimeve, investime në punë kërkimore dhe novatorizëm dhe një sërë iniciativash të tjera të ndërlydhura, të përcaktuara në SKZHI.

Papunësia. Vihet re një rritje e nivelit të përgjithshëm të papunësisë në vitin 2015, në nivelin 17.5%, (figura 44). Megjithatë, siç tregohet në Figurën 44, papunësia është në nivele shumë më të larta për të rinjtë e moshës 15-29 vjeçare (nga 19.5% në vitin 2007 në 34.2% në vitin 2015). Përqindja e papunësisë tek gratë në vitin 2014 ishte pak më e ulët sesa tek burrat (përkatësisht 15.5% dhe 19.7%). Në tregun e punës në Shqipëri vihen re dallime të rëndësishme gjinore, ku gratë përballen me nivele shumë më të ulëta punësimi nga burrat, për të gjitha grupmoshat. Mesatarisht, hendeuku qëndron tek 14 pikë përqindjeje, duke qenë se niveli i punësimit për gratë dhe vajzat e moshës nga 15-64 vjeç është në nivele 45.1% në krahasim me 59.4% që është niveli i punësimit për meshkujt (tremujori i parë i vitit 2015). Nivelet e punësimit dhe papunësisë gjatë periudhës 2009-2014 jepen përkatësisht në tabelat në vijim.


Tabela 4. Shqipëria: nivelet e punësimit dhe papunësisë (2009-13)

Viti	Përqindja e punësimit	Përqindja e papunësisë
2009	53.5%	13.8%
2010	53.5%	14.2%
2011	58.7%	14.3%
2012	56.3%	13.9%
2013	50.2%	16.1%
2014	52.1%	17.9%

Burimi: Banka e Shqipërisë, Politikat monetare

¹⁰ Burimi, INSTAT, Sondazhi për krahun e punës, 2013

Figura 35. Niveli i papunësisë në Shqipëri, 2007-14



Source: INSTAT

Një tipar tjetër i spikatur i tregut shqiptar të punës është përqindja e lartë e mungesës së aktivitetit që u rrit me 4.9% në vitin 2013, duke sjellë një rezultat 1.6 herë më të lartë për gratë sesa për burrat. Kjo nuk bën gjë tjetër vetëm se përforcon stereotipin se femrat konsiderohen si personat që e kanë vendin në shtëpi, për tu kujdesur për familjen.¹¹

Arsimi dhe formimi profesional. Rezultatet arsimore përbëjnë një faktor të rëndësishëm determinant si të performancës së tregut të punës, ashtu edhe të varfërisë. Në veçanti, arsimi dhe formimi profesional kanë tendencën të ndikojnë pozivisht në integrimin në tregun e punës dhe sigurimin e të ardhurave. Gjatë periudhës 2009-2013, arsimi dhe formimi profesional (AFP) siguroheshin përmes një sistemi të centralizuar. Sistemi nuk ka qenë në gjendje të përmbushë nevojat lokale kryesisht për shkak të ndarjes së arsimit dhe formimit profesional (siç u theksua më lart) dhe mungesës së qasjes së duhur për monitorimin dhe vlerësimin. Kjo solli si rezultat një nivel të ulët pjesëmarrjeje (14.2%) në arsimin dhe formimin profesional në këtë periudhë. Në Shqipëri, formimi i të rriturve është ende në fazat e veta fillestare, ku vetëm 1% e të rriturve të grupmoshës 25-64 vjeçare morrën pjesë në programe trainimi dhe ritrainime profesionale gjatë vitit 2012 (në krahasim me 9% që është shifra për vendet e BE-së). Në vitin akademik 2014/15 në shkollat profesionale janë regjistruar rishtazi 6,000 nxënës, që shënon një rritje të ndjeshme me 40% nga nivelet e periudhës 2013-14.

Sistemi shqiptar AFP ende është nën ndikimin e: (1) një përfshirjeje të kufizuar të partnerëve socialë – në veçanti të dobta janë marrëdhëniet midis sistemit të arsimit dhe formimit profesional nga njëra anë dhe industries nga ana tjetër; (2) faktit që pjesa më e madhe e kurikulave ofrojnë pak hapësirë për përvojë në vendin e punës dhe nuk janë të lidhura me standardet profesionale; (3) faktit që aspektet e sipërmarrjes janë të kufizuara, duke përfshirë kurikulën e AFP-së; (4) një sistem tejet i centralizuar dhe me cilësi të dobët (mbi 60% e ofruesëve publikë të AFP konsiderohen se ofrojnë nivel të ulët shërbimi dhe reagimi në përgjigje ndaj nevojave lokale)¹²; (5) mungesa e mësuesëve të kualifikuar profesionalisht, programeve të formimit të mësuesëve (para shërbimit dhe gjatë shërbimit) dhe instrumenteve të tjera të formimit të vazhdueshëm profesional; (6) vijimi i një dikotomie midis arsimit profesional dhe formimit profesional, pavarësisht se arsimi dhe formimi profesional tashmë ka kaluar në vartësinë e MMSR-së; (7) qendrat e formimit profesional janë larg të qenit efikase dhe

¹¹ Sipas përkufizimeve të INSTAT/Sondazhit për krahun e punës: Popullata që nuk është ekonomikisht aktive përfshin të gjithë personat që nuk janë të klasifikuar si të punësuar apo të vetë-punësuar (nxënës/studentë, shërbyes, në shërbimin e detyruar ushtarak, pensionistë, persona me aftësi të kufizuara, persona të papunë të shkurajuar). Shih <http://ëëë.INSTAT.gov.al/en/themes/labour-market.aspx>.

¹² MMSR, GIZ, ETF, Sondazhi bazë për ofruesit publikë të AFP në Shqipëri, 2014.

nuk e përmbushin misionin e tyre; (8) ka mungesa fondesh, stimujt janë të dobët për të garantuar pjesëmarrjen e punëdhënësve; dhe (9) siç është përmendur më herët, vijnë mangësitë në infrastrukturën dhe objektet e arsimit dhe formimit profesional, si edhe ka mangësi të kompetencave të personelit dhe kurikulës së formimit profesional.

Si pjesë e ekonomisë informale, **punësimi informal** është një ndër problemet më themelore të ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare. Kjo përbën një shqetësim në disa aspekte: (1) ndikon drejtpërdrejtë në sigurinë e vendit të punës për shkak të mungesës së kontratave të punës; (2) ndikon tek e drejta për sigurime shoqërore; (3) ul pagesën dhe burimin e të ardhurave, duke u bërë mbi mirëqënien ekonomike; (4) përbën barrë fiskale për ekonomisë përmes fenomenit të evazionit tatimor; (5) pengon zhvillimin e tregut në fusha që varen ndjeshëm nga punësimi familjar, si p.sh. bujqësia¹³; (6) rrit vulnerabilitetin dhe nxit përjashtimin e grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara, si: romët dhe egjiptianët (referoju Kutisë në vijim).

Informaliteti është i pranishëm si në sektorët e ashtu-quajtur tradicionalë dhe në ata më modernë, ashtu edhe në sektorët urbanë jashtë bujqësisë. Të punësuarit në sektorin informal nuk mbulojnë nga legjislati i punës apo nga sigurimet shoqërore, dhe as nuk kontribuojnë në sistemin e sigurimeve shoqërore. Kur vjen fjala për kushtet e punës dhe punën e papaguar familjare nivelet e informalitetit janë të larta. Pjesa më e madhe e grave të reja punojnë pa pagesë në familje, në veçanti në zonat rurale.

■ **Sfidat.** Një ndër sfidat kryesore në Shqipëri vijon të mbetet niveli i lartë i papunësisë mes të rinjve. Disa nga sfidat e tjera për këtë sektor në kuadrin e periudhës së planifikimit të SKZHI-II përfshijnë: (1) nevojën për të ulur nivelet e papunësisë dhe ato të punësimit informal përmes politikave më të mira të tregut të punës; (2) kërkesën për paketa më gjithëpërfshirëse shërbimesh dhe programesh për zgjerimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional në zonat rurale; (3) nevojën për ri-orientimin e arsimit dhe formimit profesional, me qëllim përmbushjen e nevojave faktike të tregut të punës, përmes kombinimit të mësimdhënies në teori, me punën në praktikë; (4) ri-aktivizimin e Këshillit Kombëtar të Punës, si instrument kryesor për hartimin e politikave që lidhen me pagat për punësimin dhe përfitimet sociale; (5) nevojën për heqjen e pengesave për krijimin e biznesit, me qëllim uljen e informalitetit; dhe (6) nevojën për të

Vulnerabiliteti

Nuk ekziston ndonjë përkufizim universal i pranuar mbi vulnerabilitetin, apo cilët janë grupet vulnërabël, duke qenë se këto janë terma relative, në këtë SKZHI dhe varen nga konteksti (vulnerabilitet social, ekonomik, politik, vulnerabilitet ndaj një sërë fatkeqësish apo ndryshimesh klimaterike, vulnerabilitet shëndetësor, vulnerabilitet në lidhje me korupsionin etj).

Kështu sa për ilustrim, në kuadrin e uljes së varfërisë, grupet vulnërabël janë ato që “. . .përballen me një nivel më të lartë varfërie dhe përjashtimi social nga pjesa tjetër e popullatës. Minoritetet etnike, personat me aftësi të kufizuara, të pastrehët, personat që janë abuzues substancash, persona të moshuar të izoluar dhe fëmijët shpesh përballen me vështirësi që nxisin përjashtimin e mëtejshëm social, si p.sh. nivelet e ulta të arsimit, dhe papunësia, apo nivelet e pamjaftueshme të punësimit.”

EQAVET, <http://ëëë.eqavet.eu/qc/gns/glossary/v/vulnerable-group.aspx>.

¹³ Aspekte të tjera të punësimit dhe dinamikat e krahut të punës në bujqësi diskutohen në Seksionin 12.3 të këtij dokumenti.

garantuar një lidhje dhe bashkërendim më të mirë të punësimit dhe aktiviteteve të formimit me ato të punës kërkimore dhe novatorizmit dhe sektorët e tjerë prioritarë.

Për trajtimin e gjithë këtyre shqetësimeve, në muajin nëntor të vitit 2014 qeveria miratoi “Strategjinë kombëtare mbarësektoriale për profesionet dhe aftësitë profesionale, 2014-2020”, ndërsa është ngritur edhe një GMIP për punësimin, aftësitë dhe politikat sociale.

■ **Vizioni.** *“Rritja e aftësive profesionale dhe krijimi i vendeve më të mira pune për të gjitha burrat dhe gratë”*

■ **Objektivat strategjikë¹⁴**

1. Nxitja e mundësive dinjitoze të punësimit përmes politikave më efikase të tregut të punës, sidomos përmes:

- 1.1 Ri-organizimit të zyrave të punës në kuadrin e modelit të ri të shërbimit, me synimin e rritjes së përqindjes së pjesëmarrjes vjetore të grave/burrave në programet aktive të tregut të punës;
- 1.2 Përmirësimit të kuadrit ligjor dhe atij institucional në përputhje me standardet ndërkombëtare të ratifikuara, me qëllim uljen e aksidenteve në vendin e punës dhe rritje e jetëgjatësisë së pritshme të punëtorit; dhe
- 1.3 Një rritjeje të numrit të grave dhe burrave që marrin pjesë në programet aktive, përmes një nxitjeje më të madhe të pjesëmarrjes dhe përmes garantimit të shumëllojshmërisë më të madhe dhe rritjes së efikasitetit të programeve.

2. Sigurimi i ofrimit të arsimit dhe formimit profesional cilësor (AFP) për të rinjtë dhe të rriturit përmes:

- 2.1 Një rritjeje të numrit të pjesëmarrësve në programet e AFP përmes optimizimit të rrjetit të ofruesëve të AFP-së;
- 2.2 Rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të ofruesëve të AFP-së përmes sigurimit të mbështetjes financiare dhe përshtatjes së inputeve dhe kapaciteteve të AFP-së (infrastruktura, ofiçinat, laboratorët, pajisjet, kurikulat, materialet didaktike, burimet njerëzore); dhe
- 2.3 Shtimit të lidhjeve mes studimeve dhe punës dhe lehtësimit të kalimit drejt punës nëpërmejt:
 - (i) Rritjes së përqindjessë punësimit të nxënësve që mbarojnë arsimin profesional, nga e cila 25% duhet të jenë vajza;
 - (ii) Rritjes së nivelit të punësimit mes pjesëmarrësve në kurse afatshkurtra të formimit profesional, dhe sidomos rritjes së përqindjes së grave; dhe
 - (iii) Promovimit të mëtejshëm të imazhit të arsimit dhe formimit profesional.

3. Ulja e mundësive për punësim informal dhe e përqindjes së punësimit informal në sektorët jo-bujqësorë përmes:

¹⁴ Pjesë e treguesve për objektivat e zhvillimit të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020

- 3.1 Heqjes së pengesave për ngritjen e bizneseve me qëllim uljen e informalitetit;
- 3.2 Zbatimit më me forcë të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese (si p.sh. inspektimet e punës);
- 3.3 Forcimit të bashkërendimit mes subjekteve të përfshira drejtpërdrejt apo indirekt në sektorin informal (me sektorë të tjerë si mbrojtja sociale, sigurimet shoqërore, bujqësia, financa) në nivel qendror dhe vendor;
- 3.4 Forcimit të legjislacionit, rregulloreve dhe politikave që kanë si pikësynim forcimin e mbrojtjes së punësimit, me objektiv punësimin informal (si p.sh. stimujt dhe aspektet shkurruese);
- 3.5 Forcimit dhe zbatimit të kodeve dhe standardeve që respektojnë mjedisin e punës në rastet ku ka nivele të larta të informalitetit në punësim (dmth adresimi i aspekteve të shëndetit dhe sigurisë);
- 3.6 Organizimit të programeve pro-aktive të formimit dhe punësimit, me objektiv gratë, vajzat dhe grupe të tjera vulnerabël, si komunitetet e romëve dhe egjiptianëve;
- 3.7 Një pune më të mirë kërkimore, analizash dhe informacioni në lidhje me sektorin informal;
- 3.8 Targetimit të programeve të AFP-së për segmente prioritare të tregut informal të punës (si p.sh. komunitetet vulnerabël, profesionet me rrezik të lartë etj.); dhe
- 3.9 Programeve të arsimit dhe ndërgjegjësimit që përqëndrohen si tek punëmarrësit ashtu edhe tek punëdhënësit.


11.4 Forcimi i sigurimeve shoqërore

■ **Situata aktuale.** Aktualisht, skema shqiptare e pensioneve konsiderohet të jetë financiarisht e paqëndrueshme. Të ardhurat e mbledhura nga kontributet nuk janë në gjendje të plotësojnë detyrimet për pensionet, kryesisht për shkak përqindjes së ulët të pjesëmarrjes në skemën e sigurimeve shoqërore (afërsisht 55.7% e krahut të punës) dhe një niveli të lartë korespondues informaliteti. Përfitimet nga skema aktualisht janë 41.6% e pagës mesatare, diku më poshtë mesatares evropiane.

Shpenzimet për përfitimet e papunësisë (Figura 38) gjatë vitit 2014 përbënin afërsisht 2.2% mbi bxhetin dhe ishin gjithashtu 2.4 miliardë lekë ose 10% më të larta së një vit më parë. Po ashtu përfitimet shoqërore për vitin 2014 shkuan në total 1.8 miliardë lekë, 8.8% më lart se viti paraardhës. Ndonëse nivelet e përfitimeve sociale kanë qenë relativisht të stabilizuara gjatë 10 viteve të fundit është shënuar një rritje e qendrueshme e përfitimeve për papunësinë. Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vitin 2014 arritën në 138.54 miliardë lekë, shifër kjo me 2.7 miliardë lekë më shumë nga shifra e planifikuar. Figura 46 tregon rritjen e vijueshme vjetore të pagesave.


Aktualisht Shqipëria ka një popullësi me moshë të re. Megjithatë, parashikimet afatgjata flasin për një popullatë gjithmonë e më shumë në moshim. Sipas statistikave, përqindja e popullatës në moshë pensioni parashikohet që deri në vitin 2031 të rritet me 25% dhe me 35.0% deri në vitin 2080.

Figura 37. Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, 2004-2014 (lekë billion)



Nivelet e ulta të përfitimeve nga kontributet në skemë janë pjesërisht pasojë e rritjes së informalitetit dhe deklarimeve jo reale të

pagave mbi të cilat më pas llogariten kontributet e pensioneve. Në rast se kjo situatë prevalente do të vazhdojë me gjasë ajo do të krijojë barrë mbi shërbimet sociale në të ardhmen dhe do të çojë potencialisht në përkeqësime të mëtejshme me kalimin e kohës. Sa për ilustrim, nëse kjo ndryshon, përfitimet e ardhshme që paguhen nga sistemi, si përqindje e pagës mesatare mund të jenë më të ulta nga përqindja aktuale dhe kjo mund të shkaktojë rritjen e presionit mbi deficitin fiskal.



Nëse vazhdojnë këto nivele të ulta të pjesëmarrjes, një përqindje e konsiderueshme e popullatës nuk do të mund të përfitojë nga pensionet.

Megjithatë, reformat e zbatuara plotësisht do të nxisnin pjesëmarrjen në skemë duke lidhur masat për pensionet me kontributet e paguara. Në këtë rast, numri i kontribuesëve mund të rritej nga niveli aktual prej 705 mijë përfituesish në 759,000 mijë deri në vitin 2018 dhe 778,000 mijë deri në vitin 2020. Numri i viteve të kontributeve do të rritet gjithashtu

nga 35 që është në vitin 2015 në 37 deri në vitin 2020. Kjo do të sjellë ulje të deficitit të skemës nga 1.6% e PBB në vitin 2015 në 1% deri në vitin 2018 dhe më pas.

Për të trajtuar këto çështje dhe për të siguruar qendrueshmërinë afatgjatë të sistemit, qeveria nisi një sërë reformash për pensionet në fillim të vitit 2014. Reformat u institucionalizuan përmes ndryshimeve të nevojshme të ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i cili u miratua në muajin korrik të vitit 2014, ndërsa zbatimi i tij nisi nga fillimi i vitit 2015.¹⁵

Tabela 5. Numri i parashikuar i përfituesëve, 2015 – 2020 (në '000')

	2015	2016	2020
Total	571.2	583.3	631.7
Pensionistë	436.8	445.0	478.6

Burimi: MMSR/ Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Reformat drejtohen nga një grup ndërsektorial me një pjesëmarrje të gjerë të partnerëve socialë dhe aktorëve të tjerë të interesit. Vendimet për reformat bazohen mbi konsultime të gjera me publikun. Si pjesë e hartimit të dokumentit të politikave për reformën u ndërtuan disa skenarë ku përfshihen praktikatat më të mira ndërkombëtare për administrimin e pensioneve, prej të cilave u zgjodhën më të përshtatshmit, duke u përqëndruar tek forcimi i lidhjeve midis kontributeve individuale dhe shumës së paguar për përfitimet. Skenari i përzgjedhur që pasqyron thjeshtësinë, fleksibilitetin dhe transparencën gjithashtu parashikon përshtatje në formulën e llogaritjes së pensioneve bazuar mbi faktorët e ndryshueshëm demografikë, shoqërorë, fiskalë dhe variabla të tjerë. Me zbatimin e reformave të propozuara parashikohet që ato të sjellin një ulje më të shpejtë të deficitit financiar të skemës nga një shifër e parashikuar prej 1.6% e PBB-së në vitin 2015 në 1.0% deri në vitin 2018, në 0.4% të PBB-së deri në vitin 2030 dhe pastaj eventualisht në 0% deri në vitin 2043. Kjo skemë e re, do të garantojë ruajtjen e

¹⁵ Sikundër theksohet në nën-seksionin më lart, qeveria ka evidentuar "punësimin, aftësitë profesionale dhe politikatat shoqërore" si një nga katër pilotët për qasjen sektoriale. Në dhjetor 2015 është miratur Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 dhe Plani I saj i Veprimt dhe në shkurt 2016 është miratuar Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale 2015-2020 (ku përfshihet siguria sociale, ndihma ekonomike, politikatat për grupet me nevoja të posaçme: personat me aftësi të kufizuara, Romët, strehimi). Gjithashtu, është hartuar "Dokumenti për politikatat e pensioneve".

përfitimeve, pasi në skemën e mëparshme , përqindja e zëvendësimit parashikohej mbi 30% deri në vitin 2032 dhe duke shënuar një rënie të ndjeshme deri në 25% për vitin 2039, në 18% në vitin 2050 dhe në një nivel shumë të ulët prej 6.2% deri në vitin 2080.

■ **Sfidat.** Sfidat dhe prioritetet kryesore në reformën e pensioneve gjatë periudhës së planifikimit 2015-2020 përfshijnë: (1) nevojën për forcimin e parimit të kontributit të sistemit të pensioneve dhe sigurimit të një përqindjeje më të madhe të pjesëmarrjes, duke krijuar mundësi më të mëdha për pensione më të larta, me supozimin që periudhat e pjesëmarrjes do të jenë më të gjata dhe do të ketë një rritje të shumave të kontributit bazuar mbi paga më të larta; (2) nevojën për përmirësimin e qendrueshmërisë financiare të skemës dhe uljen e deficitit; (3) nevojën për të gjetur rrugë dhe mënyra për sigurimin e pensioneve sociale për shtetasit rezidentë pa të ardhura nga një pension pleqërie; (4) unifikimin e kriterëve për përfitime pensionesh si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, duke i kombinuar në një skemë të vetme; dhe (5) nevojën për një nivel më të lartë koordinimi të skemave me vende të tjera të rajonit dhe me BE-në.

■ **Vizioni.** *“Mbulimi përmes elementëve të sigurimeve shoqërore për të gjithë shtetasit shqiptarë, duke siguruar përfitime të mjaftueshme, me qëllim lehtësimin e varfërisë për moshën e tretë, përmes forcimit të natyrës kontributive dhe solidaritetit të sistemit”*

■ Objektivat strategjikë

1. Rritja e përqindjes së pjesëmarrjes së popullatës në moshë pune në skemën e sigurimeve përmes:

- 1.1 Zbatimit të formulës së re për përlogaritjen e pensioneve duke hequr kufizimet mbi maksimumin e lejueshëm të përfitimeve, kombinuar me lidhjen e pensioneve me pagat e viteve të fundit të punës;
- 1.2 Forcimit të mbledhjes së kontributeve përmes zbatimit të ligjit dhe rregulloreve dhe uljes së nivelit të informalitetit përmes një bashkërendimi më të mirë të të gjitha agjencive të zbatimit; dhe
- 1.3 Identifikimit të pagës minimale kontributive me pagën minimale zyrtare dhe indeksimin e pagës maksimale kontributive, sipas rritjes së pagës mesatare.

2. Rritja e qendrueshmërisë financiare të skemës dhe ulja e deficitit përmes:

- 2.1 Rritjes të të ardhurave nga kontributet;
- 2.2 Rritjes së numrit të personave që kontribuojnë në sistem;
- 2.3 rritjeje të synuar në numrin e viteve të kontributit në skemën e sigurimeve shoqërore nga 35 vjet në vitin 2015 në 37 vjet deri në vitin 2020;
- 2.4 Një rritje graduale e synuar e moshës së daljes në pension për gratë me dy muaj në vit për të arritur moshën 61 vjeç deri në vitin 2020; dhe
- 2.5 Zbatimit të skemës së unifikuar për zonat urbane dhe rurale deri në vitin 2018.

3. Sigurimi i një koordinimi më të mirë të skemave të sigurimeve shoqërore me ato të vendeve të tjera të rajonit dhe në veçanti me ato të BE-së, si edhe garantimi i mbrojtjes gjithëpërfshirëse shoqërore për gjithën popullatën migratore përmes:

- 3.1 Zbatimit të marrëveshjeve të ratifikuara nga Turqia dhe Belgjika;
 - 3.2 Ratifikimit të marrëveshjeve me Hungarinë, Luksemburgun dhe Romaninë dhe zbatimit të tyre;
 - 3.3 Përfundimit të negociatave për marrëveshjet me Kandanë, Republikën Ceke, Maqedoninë dhe miratimit të këtyre marrëveshjeve nga Këshilli i Ministrave dhe ratifikimit nga parlamenti shqiptar; dhe
 - 3.4 Fillimit të negociatave për marrëveshjet dypalëshe me Gjermaninë, Austrinë, Spanjën, Bullgarinë.
- 4. Sigurimi i të ardhurave të duhura nga pensionet për pensionistët dhe të moshuarit dhe ruajtja dhe përmirësimi i standardeve të jetesës përmes:**
- 4.1 Krijimit të kuadrit regulator për fondet e pensioneve, në përputhje me indeksin e rritjes së çmimeve të konsumit; dhe
 - 4.2 Rritjes së sigurimit të pensioneve sociale për personat mbi 70 vjeç që nuk kanë mundur të kontribuojnë në skemën e pensioneve.
- 5. Fuqizimi i planifikimit, zbatimit dhe administrimit në përgjithësi të sistemit të sigurimeve shoqërore, me qëllim rritjen e sigurisë, efijencës dhe transparencës përmes:**
- 5.1 Automatizimit të sistemit të sigurimeve shoqërore, përpilimit të procedurave të verifikimit, caktimit, përlllogaritjes dhe kontrollit të pagesave të përfitimeve;
 - 5.2 përmbylljes së procesit të dixhitalizimit të vjetërsisë në punë dhe periudhës së sigurimeve,
 - 5.3 krijimit të llogarive personale, rritjes së transparencës dhe manaxhimit më të mirë të fondeve;
 - 5.4 përmirësimit të shërbimeve për qytetarët përmes uljes së kohës për dhënien e pensionit.

11.5 Menaxhimi i migracionit

■ **Situata aktuale.** Migrimi vazhdon të jetë një element i rëndësishëm në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë. Në përgjithësi, Shqipëria ende konsiderohet si një vend i origjinës së emigrantëve ekonomikë, si dhe vend tranzit dhe i destinacionit për emigrantët ekonomikë, azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Vendi është mjaft i varur nga dërgesat e emigrantëve. Në vitin 2007, dërgesat e emigrantëve arritën nivelin më të lartë, 953.000.000 euro, të cilat më pas filluan të bien dhe në vitin 2013 arritën shumën më të ulët prej 544 milionë euro. Gjatë vitit 2014, ka pasur një rritje të lehtë për 592 milion euro, një fenomen që tregon fillimin e përmirësimit të pozitës së emigrantëve shqiptarë në tregjet e punës të vendeve pritëse.¹⁶ Ndërsa rrjedha e emigrimit të qytetarëve shqiptarë ka treguar shenja të moderimit, fluksi i qytetarëve shqiptarë që kërkojnë azil në shtetet anëtare të BE kryesisht në baza ekonomike është rritur në vitin 2015 me rreth 3,5 herë krahasuar me vitin 2014 (59,030 raste për periudhën janar - nëntor 2015 kundrejt 16,945 në

¹⁶ Extended Migration Profile for Albania 2012-2014

vitin 2014).¹⁷ Nga ana tjetër, shkalla e refuzimit të kërkesave për azil është e lartë dhe prandaj kthimet eventuale në Shqipëri nga shtetet anëtare të BE-së janë gjithashtu të larta, më shumë se dyfishi i vitit 2014 (25,100 në 9 muajt e parë të vitit 2015 kundër 12,295 për të gjithë vitin 2014).¹⁸

Viti 2015 është karakterizuar nga flukse të larta të lëvizjeve të përziera migratore brenda Ballkanit Perëndimor, duke u përpjekur për të arritur vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE). Numri u rrit 2-3 herë në krahasim me vitin 2014, duke arritur një numër të përgjithshëm prej 627,527.¹⁹ Grupi më i madh i hyrjeve në Ballkan është e përfaqësuar nga sirianët, duke përbërë rreth 75 për qind të rrjedhës së përgjithshme. Rruga më e zakonshme e migrimit nëpërmjet Ballkanit Perëndimor ishte nëpërmjet Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nga Greqia, pastaj për në Serbi dhe Hungari.²⁰ Shqipëria nuk është ende "një vend i preferuar tranziti apo destinacioni" i migrimit të përzier në rajonin e Ballkanit Perëndimor, por rreziku i një fluksi të papritur dhe të madh në kufijtë e Shqipërisë është e lartë. Reagimet efektive për flukse migratore komplekse në Mesdhe (gatishmëri për flukset masive të azilkërkuesve dhe refugjatëve), paraqesin sfida institucionale, si dhe ligjore për autoritetet shqiptare. Qeveria e Shqipërisë është duke përfunduar një plan emergjence për një kriza të mundshme të migrimit dhe refugjatëve.

Kjo dinamikë intensive në lëvizjet migratore jashtë dhe brenda vendit, kërkon një qasje ndërsektoriale të qeverisjes së migrimit, me qëllim adresimin e sfidave që lidhen me flukset komplekse të migrimit (migrimi i parregullt, azilkërkuesit dhe refugjatët, të miturit e pashoqëruar, etj), si dhe për të rritur impaktin e zhvillimit të migrimit (kanalizimin e remitancave dhe njerëzore dhe investimet financiare). Vendit i mungon një politikë koherente e qeverisjes migracionit, e cila do të udhëheqë të gjitha veprimet programatike në fushën e migracionit. Prandaj është e rëndësishme që Shqipëria të zhvillojë një politikë mbi migracionin që të përfshijë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me qeverisjen e migracionit, duke përfshirë emigrimin dhe migrimin e shtetasve shqiptarë, emigracionit të huajve dhe ndikimin e migrimit në zhvillimin e Shqipërisë.

■ **Sfidat.** Pavarësisht progresit në menaxhimin me efektivitet të migracionit në Shqipëri, pas zbatimit të Strategjisë së parë Kombëtare për Migracionin (2005-2010) dhe Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer (2010-2015), disa sfida mbeten të patrajtuara: (i) *Parandalimi i migrimit të parregullt* nga vendi, keqpërdorimin e regjimit pa viza në zonën Shengen të BE-së; (ii) *Kthimi i qëndrueshëm* i shqiptarëve përmes ofrimit të mbështetjes për riintegrim; (iii) *ndikimi i zhvillimit të migrimit* duhet të forcohet, ndër të tjera me anë të promovimit të investimeve njerëzore dhe financiare të shqiptarëve që janë jashtë vendit për vendin; (iv) *forcimi i strukturave të menaxhimit të migracionit dhe politikave paraprake të imigracionit dhe zbatimi i tyre* bazuar në fakte solide dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë sigurimin e të drejtave të njeriut të të gjithë emigrantëve.

■ **Vizioni.** “Krijimi i një sistemi efektiv të qeverisjes së migracionit në Shqipëri”

¹⁷ Të dhënat e EUROSTAT

¹⁸ Si më sipër

¹⁹ Të dhënat jozyrtare lidhur ekskluzivisht me të ashtuquajturat kufijtë "blu", siç rrjedhin nga të dhënat e mbledhura nga stafi i IOM-it në Greqi dhe autoritetet greke (1/1 / 2015-04 / 11/2015).

²⁰ Në gusht 2015, mbi 3.000 emigrantë kanë kaluar çdo ditë kufirin nëpërmjet Greqi - IshRepublikës Jugosllave të Maqedonisë, dhe kjo shifër arriti në 7,000 në fillim të shtatorit 2015.

■ Objektivat strategjike

1. **Nxitja e kanaleve të sigurta dhe të rregullta për migrimin në Shqipëri me qëllim parandalimin e migracionit të parregullt, për të kanalizuar 70% të migrimit nga Shqipëria nëpërmjet marrëveshjeve të rregullta bilaterale (ekzistuese dhe atyre të reja me vendet e BE-së dhe jo të BE-së)**
 - 1.1 Rritja e efektivitetit të zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese të migracionit të punës me vendet e destinacionit duke rritur numrin e marrëveshjeve të reja për të siguruar rekrutimin etik dhe mbrojtjen e të drejtave;
 - 1.2 Përfshirja e programeve të praktikës në ndërmarrjet e huaja, në marrëveshjet e migracionit të punës, si një mjet për të rritur aftësitë dhe punësimin e fuqisë punëtore në Shqipëri;
 - 1.3 Rritja e numrit të marrëveshjeve të këmbimit të rinjve me vendet e BE-së, duke përfshirë programet e praktikës, me qëllim rritjen e punësimit të të rinjve;
 - 1.4 Përmirësimin e legjislacionit në fushën e migracionit të punës, e cila përfshin aftësi migrimit bazuar dhe aftësitë njohje;
2. **Rritja e ndikimit të zhvillimit të emigrimit duke krijuar mekanizma të favorshme ligjore dhe institucionale për:**
 - 2.1 Përmirësimi i shërbimeve në lidhje me dërgesat e emigrantët, në mënyrë që të kanalizohen dërgesat e emigrantëve drejt investimeve në Shqipëri;
 - 2.2 Mbrojtja e të drejtave të emigrantëve shqiptarë ku ata jetojnë, duke kërkuar një trajtim të barabartë sipas standardeve ndërkombëtare në këtë fushë;
 - 2.3 Hartëzimi, ndërtimi i besimit, mobilizimi dhe organizimi i komuniteteve shqiptare jashtë vendit, me qëllim krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit me komunitetet shqiptare jashtë vendit;
 - 2.4 Atraksioni i shqiptarëve jashtë vendit me qëllim zgjerimin e iniciativave të siper marrjes në Shqipëri, për promovimin e investimeve, filantropisë, transferimin e teknologjisë dhe inovacionit.
3. **Rritja e qëndrueshmërinë së migracionit të kthimit me mbështetjen e riintegrit të emigrantëve të kthyer**
 - 3.1 Rritja e kapaciteteve të Sporteve të Migracionit për të siguruar informacion dhe mbështetje për kategori të ndryshme të emigrantëve;
 - 3.2 Përmirësimi i veprimeve për njohjen e aftësive dhe kualifikimeve (formale dhe joformale) të marra jashtë vendit nga qytetarët shqiptarë dhe integrimin e tyre në tregun e punës.
 - 3.3 Përmirësimi i masave aktive të tregut të punës, duke përfshirë trajnimin e AFP-së, për emigrantët e kthyer për të lehtësuar riintegrimin e tyre.
 - 3.4 Nxitja e vetë-punësimit dhe aktiviteteve të sipërmarrjes në mesin e migrantëve të rikthyer në zonat rurale dhe formalizimin e aktiviteteve të tyre.
4. **Zbatimi i avancuar i politikave të migracionit, në mënyrë që të sigurojë trajtimin e barabartë të shtetasve të vendeve të tjera dhe integrimin e tyre në Shqipëri, në përputhje me standardet ndërkombëtare.**

- 4.1 Hapa të avancuar për të siguruar që e drejta për të kërkuar dhe për të fituar azil në Shqipëri është respektuar plotësisht.
 - 4.2 Rritja e kapaciteteve institucionale për adresimin e rritjes së rrjedhës së migrimit të përzier nëpërmjet Shqipërisë;
 - 4.3 Rishikimi i sistemit të paraburgimit të emigracionit në mënyrë që paraburgimi të përdoret si mjeti i fundit, në respektim të plotë të të drejtave të njeriut të migrantëve.
 - 4.4 Vlerësimi i situatës dhe gëzimi i të drejtave të punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre që jetojnë në Shqipëri, në mënyrë që të ndërmarren masa për të nxitur integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike të kategorive të ndryshme të të huajve që banojnë në vend.
- 5. Konsolidimi i politikës së migracionit, kuadrit ligjor, strukturave të menaxhimit dhe koordinimit, në mënyrë që të sigurohet reagim më i mirë ndaj sfidave të migracionit.**
- 5.1 Plotësimi i kuadrit të politikave për menaxhimin e migracionit duke miratuar një dokument të politikave dhe plan veprimi për qeverisjen e migrimit, si dhe dispozitat e nevojshme ligjore;
 - 5.2 Rritja e efikasitetit të koordinimit ndërmjet strukturave të ndryshme të menaxhimit të migracionit në nivel kombëtar dhe lokal;
 - 5.3 Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave dhe sigurimi i monitorimit efektiv dhe mekanizmi të vlerësimit për menaxhimin e migracionit; rinovimi rregullisht i profilit të Zgjerimit të Migracionit (Extended Migration profile).

11.6. Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore

■ **Situata aktuale.** Mbrojtja shoqërore garanton që përfitimet e rritjes ekonomike të shkojnë deri tek personat më të varfër dhe më të marginalizuar: kështu p.sh Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve janë disa prej instrumenteve ligjore që e përcaktojnë mbrojtjen shoqërore si mjet për mbrojtjen e shtetasve më vulnerabël. Modelet nga vendet në zhvillim rezultojnë se programet e mbrojtjes shoqërore mund të rrisin efektivisht dhe ta përmirësojnë gjendjen ushqimore, arsimore dhe shëndetësore të fëmijëve dhe të ulin rrezikun për abuzimin dhe shfrytëzimin e tyre, me përfitime afatgjata.

Në Shqipëri, politikat e mbrojtjes shoqërore janë përqëndruar tek Ndihma Ekonomike, përfitimet për aftësinë e kufizuar dhe disa shërbime të kujdesit social/rezidencial.²¹ Përsa i takon mbështetjes faktike, shpenzimet në total për asistencën sociale në Shqipëri janë tek 1.6% e PBB-së që krahasohet me mesataren e rajonit për Evropën dhe Azinë Qendrore (ECA)²². Tri skemat kryesore të mbrojtjes shoqërore që janë zbatuar në Shqipëri janë: programi i Ndihmës Ekonomike, përfitimi për paaftësinë, shërbimet e kujdesit social.²³


²¹ **Mbrojtja sociale** përfshin“. . .të gjitha ndërhyrjet nga subjekte publike apo private që kanë si synim clirimin e familjeve dhe individëve nga barra e një sërë risqesh apo nevojash të përcaktuara, me kusht që të mos përfshihet asnjë marrëveshje simultane reciproke apo individuale”. Burimi: EU, Social Protection Performance Monitor (SPPM), 2015, fq 19.

²² Banka Botërore 2010; dokumenti i politikave për asistencën sociale

²³ Gjithashtu, fusha e mbrojtjes sociale do të përfshihet në sektorin pilot për “punësimin, aftësitë profesionale dhe politikat sociale” sin jë nga katër pilotët për qasjen sektoriale. , Në dhjetor 2015 është miratur Strategjia Kombetare e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 dhe Plani i saj i Veprimit dhe në shkurt 2016 është miratuar Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale 2015-2020.

Programi i **Ndihmës Ekonomike** – (NE) përfaqëson skemën kryesore të uljes së varfërisë që mbulohet nga strategjia e mbrojtjes sociale. Rezultojnë për periudhën 2014 se rreth 80,000 familje përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Shpenzimet në kuadrin e programit të NE janë relativisht mirë të përqëndruara tek ulja e varfërisë me kuintilin më të varfër (20%) të popullatës dhe marrin 56% të shpenzimeve NE. Megjithatë, mbulesa e familjeve të varfra është e ulët (në vitin 2013 mbuloheshin vetëm 23% e familjeve në varfëri ekstreme) dhe administrimi nuk është efikas. NE përfaqëson vetëm afro 15 % të niveleve për familjet *me varfëri absolute*. Pagesa mesatare e ndihmës ekonomike varijon afërsisht 3,800 lekë në muaj dhe ndikimi i saj në uljen e varfërisë mbetet i kufizuar.²⁴

Në përgjithësi, shpenzimet për ndihmën ekonomike pësuan një farë rritjeje në terma nominale gjatë dekadës së fundit, por pësuan rënie si përqindje e PBB-së. Po kështu, numri i familjeve që përfitonin nga ndihma ekonomike ra me pothuaj një të tretën (31.6%), me një rënie të veçantë gjatë periudhës 2013-2014, që korespondon me futjen e reformave administrative (shih figurën



39).

Pagesa për paaftësinë (PA). Instrumenti kryesor që përdoret nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR) në mbështetje të personave me aftësi të kufizuar është pagesa e paaftësisë. Shpenzimet për pagesën e paaftësisë shënuan një rritje të shpejtë gjatë viteve të fundit dhe aktualisht përbëjnë komponentin kryesor të shpenzimeve për asistencën sociale. Kjo është drejtuar nga indeksimi vjetor i përfitimit dhe nga rritja e mbulesës. Niveli i pagesës së paaftësisë është shumë më i lartë nga ai i ndihmës ekonomike. Më specifikisht, shuma që përfiton një person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore është 9,900 lekë në muaj (në krahasim me një pagesë prej vetëm 3,800 lekë ndihmë ekonomike për një familje mesatare).

Në përgjithësi, shpenzimet për aftësinë e kufizuar shënuan një rritje të ndjeshme në terma nominale gjatë dekadës së fundit dhe ndryshe nga ndihma ekonomike ato janë rritur si përqindje e PBB-së. Po kështu, numri i personave që kanë marrë pagesa të paaftësisë është rritur me 2/3 (63.7%) për të arritur në mbi 160,000 persona (Figura 47).

²⁴ Shih URI/NCSS, *Reforming Economic Aid: from survival to investment in poverty reduction*, UNICEF, 2011.

Ndonëse skema e pagesës së paaftësisë nuk është e ndërtuar drejtpërdrejtë për uljen e varfërisë praktikisht një e pesta më e varfër i popullatës merr 39 % të shpenzimeve për aftësinë e kufizuar. Megjithatë, si në shumë vende në tranzicion mbeten çështje serioze në lidhje me funksionimin e skemës. Sistemi i vlerësimit është plotësisht mjekësor dhe nuk pasqyron nivelin e seriozitetit të aftësisë së kufizuar apo kufizimit funksional. Qeveria ka rënë dakord për një proces të reformës administrative të skemës (me mbështetje nga Banka Botërore) që ka si synim ri-përqëndrimin e fokusit të pagesave tek personat me forma më të rëndëa të aftësisë së kufizuar.

Shërbimet e kujdesit shoqëror. Aktualisht shërbimet publike të kujdesit shoqëror (me përjashtim të shërbimeve të kufizuara institucionale) në Shqipëri janë shumë të kufizuara. Pjesa më e madhe e shërbimeve të kujdesit shoqëror ofrohen nga organizata të shërbimeve komunitare të financuara me baza vullnetare ose nga partnerë zhvillimi. Shërbimet gjenden kryesisht në zonat e mëdha urbane (90% janë në zonat urbane) dhe 75% janë në pjesën qendrore dhe perendimore të vendit.²⁵

■ **Sfidat.** Sfidat kryesore që duhen trajtuar në sektorin e mbrojtjes shoqërore gjatë periudhës së planifikimit 2015-2020 përfshijnë: (1) nevojën për rritjen e efikasitetit të skemës së asistencës financiare, duke kaluar nga një skemë pasive tek ajo aktive përmes programeve të përfshirjes sociale dhe alternimit të tyre me skemat e punësimit; (2) nevojën për krijimin e sistemeve funksionale dhe efikase të kujdesit shoqëror, të bazuara mbi parimin e diversifikimit, decentralizimit dhe de-institucionalizimit për të siguruar një targetim më të mirë dhe përfshirje më të madhe të grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes shoqërore, me fokusin tek individit dhe familja; dhe (3) nevojën për partneritet me OJQ-të dhe ofruesit privatë të shërbimeve, për të kompensuar burimet e kufizuara shtetërore në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.

■ **Vizioni.** *“Ndërtimi i një sistemi të mbrojtjes shoqërore me qëllim reduktimin e pabarazive ekonomiko-shoqërore, duke krijuar një sistem me politika dhe mekanizma për mbrojtjen e të gjithë individëve vulnerabël dhe të përjashtuar përmes programeve parandaluese dhe atyre të përfshirjes sociale, të kombinuar me skemat e punësimit”*

■ Objektivat strategjikë

1. Zbutja dhe ulja e varfërisë dhe asaj absolute përmes:

- 1.1 Rritjes së efikasitetit dhe transparencës së skemës nëpërmjet percaktimit më të mirë të familjeve të varfra;
- 1.2 Modernizimit të skemës së ndihmës ekonomike përmes zbatimit të regjistrimit kombëtar elektronik dhe formulës unike të rezultateve;
- 1.3 Rritjes së kapaciteteve të strukturave lokale, rajonale dhe qendrore, në fushat që përfshijnë manaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës;
- 1.4 Përmirësimit të auditit të skemës, me qëllim uljen e rasteve të mashtrimeve;
- 1.5 Transformimit të skemës në një skemë aktive përmes skemës së ri-integrimit shoqëror: përfituesëve do të përfshihen në politika aktive të tregut të punës, duke krijuar paketa të shërbimeve të integruara dhe mundësi punësimi.

²⁵ Studim i UNICEF-it për hartën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

- 2. Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara** përmes vlerësimit bio-psiko-social, bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke kombinuar skemën e pagesës Cash me shërbime të integruara, për të arritur integrimin e tyre social dhe ekonomik. Qëllimet specifike:
- 2.1 Reformimit të sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar: zbatimi i sistemit të ri të vlerësimit sipas “modelit social” dhe ulja e përqindjes së e përfutuesëve pa aftësi të kufizuar;
 - 2.2 Rritjes së transparencës së skemës përmes krijimit të regjistrit elektronik: fillimisht nëpërmjet pushteteve vendore në qarqet pilote, të cilat do të zbatojnë procedurat që lidhen me skemën e paaftësisë përmes këtij regjistri;
 - 2.3 Krijimit të një sistemi të integruar të shërbimeve që kombinon shërbimet e kujdesit shoqëror me pagesat në para *cash*: personave me aftësi të kufizuar do tu ofrohet një paketë e integruar shërbimesh; dhe
 - 2.4 Krijimit dhe forcimit të mekanizmit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve në nivel qendror dhe vendor: prodhimii raporteve tremujore të skemës së performancës, vlerësimit të profilit të riskut dhe zbulimit të mashtrimeve, për hartuesit e politikave.
- 3. Të garantohet që çdo fëmijë, çdo person i moshuar dhe çdo familje shqiptare të ketë akses të barabartë në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror funksional dhe gjithëpërfshirës, bazuar mbi parimin e decentralizimit, de-institucionalizimit dhe diversifikimit përmes:**
- 3.1 Vendosijs së një sistemi të integruar të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore dhe në nivel kombëtar;
 - 3.2 Rishikimit të funksioneve të planifikimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror për nivelet e ndryshme të pushtetit qendror dhe zbatimit të modeleve të reja;
 - 3.3 Krijimit të një sistemi të informacionit të integruar në nivel rajonal dhe kombëtar, me qëllim evidentimin dhe referimin e nevojave për shërbimet e kujdesit shoqëror;
 - 3.4 Krijimit dhe forcimit të sistemit të monitorimit dhe inspektimit të shërbimeve sociale në nivel qendror, lokal dhe rajonal;
 - 3.5 Profesionalizmit të ofruesëve të shërbimeve të punës dhe atyre sociale përmes krijimit të një sistemi kualifikimesh dhe
 - 3.6 Rritjes së ndërgjegjësimit dhe fushatave publike, me qëllim parandalimin e problemeve sociale, por edhe me rritjen e aksesit ndaj shërbimeve të kujdesit social.

11.7 Ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse

■ **Situata aktuale.** Përfshirja sociale lidhet me masa ndaj individëve dhe grupeve për të pasur akses të barabartë në shërbimet publike, si dhe për të garantuar pjesëmarrjen e tyre të plotë në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të shoqërisë ku ata jetojnë. Politikat që mbështesin përfshirjen kanë si synim garantimin e aksesit të të gjithë shtetasve tek shërbimet publike cilësore si dhe dhe të mirave publike që rrisin mirëqënien e tyre.

Politikat e përfshirjes sociale në Shqipëri janë kryesisht të përqëndruara mbi aspekte të lehtësimit të varfërisë, mirëqënies dhe përfshirjes së grupeve vulnerabël, si fëmijët, të rinjtë, minoritetet vulnerabël (Romët dhe Egjiptianët), personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe ata që jetojnë në zona të largëta/të pazhvilluara.


Përsa u takon tendencave në Shqipëri, niveli i varfërisë si shprehje direkte e përjashtimit social ka shënuar rritje në 14.3% në vitin 2012, në krahasim me shifrën 12.5%

Përfshirja sociale . . .

“ . . . përkufizohet si procesi ku individë të caktuar shtyhen në marzhet e shoqërisë dhe parandalohen nga pjesëmarrja e plotë në shoqëri për shkak të varfërisë, apo mungesës së aftësive bazë dhe mundësive për tu përfshirë në tregun e punës, ndërsa në këtë dokument politikash është i përkufizuar si reagim ndaj fenomeneve të përjashtimit social, të cilat ndodhin në një shoqëri që vuan nga mungesa e aksesit ndaj shërbimeve efikase publike. Trajtimi i përjashtimit social përfshin masat që u bëjnë të mundur individëve dhe grupeve të kenë akses në shërbimet publike në mënyrë që të marrin pjesë në maksimumin e mundshëm të aftësive të tyre në jetën ekonomike-shoqërore të vendit. Politikat e përfshirjes sociale kanë si synim sigurimin e aksesit të të gjithë shtetasve për shërbime publike me cilësi të mirë”.

MMSR, dokumenti i politikave për përfshirjen sociale 2015-2020: Matja, monitorimi dhe raportimi për politika të drejtuara nga rezultatet, ugusht, 2015, fq 128.

Figura 40. Treguesit e varfërisë sipas rajoneve: përqindja e varfërisë për frymë (%)



Burimi: INSTAT

në vitin 2008²⁶ (Sondazhi i Matjes së Standardeve të jetesës – LSMS – anketë që kryhet cdo 4-5 vjet) dhe është dyfishuar me një hendek në rritje midis rajoneve²⁷ me përjashtim të zonave malore, siç tregohet në Figurën 40. Përqindja e personave që jetojnë në varfëri ekstreme pothuajse është dyfishuar gjatë viteve 2008-2012, nga 1.2% në vitin 2008 në 2.3% në vitin 2012.

Këto tendenca përgjithësisht tregojnë se politikat e qeverisë për uljen e varfërisë dhe rritjen e përfshirjes sociale dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabël kanë kontribuar ndjeshëm në uljen e varfërisë apo në përmirësimin e mirëqënies së individëve. Kjo për shkak të një sërë faktorëve: mungesës së planifikimit buxhetor, koordinimit institucional të pamjaftueshëm, mungesës së platformave lokale në mbështetje të grupeve në disavantazh, mungesës së të dhënave

²⁶ INSTAT, 2013.

²⁷ Rajonet: bregdetare, qendrore, malore dhe pjesa urbane e Tiranës janë të ndarë me rrethe (në vitin 2002 kur nisi sondazhi), të grupuara bashkë sipas afërsisë gjeografike dhe ngjashmërive të fenomeneve që studioheshin. Ato janë të ndryshme nga ndarjet administrative: rrethet dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore.

statistikore në nivel kombëtar dhe rajonal dhe burimeve të pamjaftueshme financiare. Pa trajtuar këto probleme, zbatimi i politikave nuk do të jetë efikas.²⁸

■ **Sfidat.** Sfidat dhe prioritetet kryesore që duhen trajtuar në fushën e përfshirjes sociale gjatë periudhës së planifikimit për SKZHI-II 2015-2020 përfshijnë nevojën për: (1) trajtimin e shkaqeve që çojnë në përjashtim nga jeta ekonomike, shoqërore dhe politike për çdo qytetar të përjashtuar; dhe (2) nevojën për parandalimin e diskriminimit përmes nxitjes së barazisë, në përputhje me traktatet e të drejtave të njeriut dhe sigurimit të integritetit të Shqipërisë në BE. Kjo do të kërkonte nevojën për:

- (a) Identifikimin dhe trajtimin e sfidave që dalin përballë monitorimit dhe matjes së përfshirjes sociale duke u bazuar tek treguesit e BE-së dhe ata kombëtarë që kërkojnë për mbështetjen e uljes së varfërisë dhe hartimit të masave efektive që rrisin mirëqënien;
- (b) Nxitjen e koherencës së politikave, përcaktimin e prioritetëve dhe përgjegjësi për zbatimin e monitorimit dhe matjes së përfshirjes sociale; dhe
- (c) Bërjen më transparente të efektit të politikave të ndjekura dhe përpjekjeve të qeverisë për përfshirjen e politikave që kanë impakt mbi përfshirjen sociale.

Vendosja e sistemeve për mbështetjen e funksioneve të përfshirjes sociale të administratës publike deri më tani ka qenë shumë e fragmentuar. Janë ndjekur tematika të ngushta të veçuara, pa i kushtuar vëmendje ndërvarësive që ekzistojnë ndërmjet intensitetit, shkaqeve dhe llojeve të përfshirjes sociale, apo përdorimit të treguesve të BE-së dhe atyre kombëtarë për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale në fushat e ndryshme të politikave.

Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale (DPPS) 2015-2020 i miratuar në 2015 shpreh vizionin, shtrirjen dhe objektivat për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale duke i shndërruar në një plan veprimesh të prioritizuara. Në këtë kuadër DPPS-së do të garantojë një sistem për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale në të gjitha fushat e politikave të uljes së varfërisë dhe mbrojtjes sociale, punësimit dhe mbështetjes për sipërmarrjen, arsimin, shëndetin, strehimit e nevojave bazë, si dhe pjesëmarrjes e të drejtave e njeriut; dhe të nxisë transparencën dhe përgjegjshmërinë në mënyrën se si matet dhe përdoret përfshirja sociale për të informuar performancën e shërbimeve sociale.

Përdorimi i SAKJ dhe rregullsia e ABF dhe AFP do të sjellin ndryshime në kulturën e ligjërit politik për varfërinë dhe përfshirjen sociale dhe do të hapë perspektiva për përdorimin e treguesve të përfshirjes sociale për vlerësimin performancën dhe rezultatet e politikave.

²⁸ Po kështu, përfshirja sociale do të mbulohet në qasjen e sektorit pilot për “punësimin, aftësitë profesionale dhe politikën shoqërore”, si edhe në Strategjinë kombëtare ndër-sektoriale për *përfshirjen sociale dhe mbrojtjen shoqërore, 2015-2020*”.

- **Vizioni.** *“Një shoqëri gjithëpërfshirëse, që krijon akses të barabartë për të gjithë qytetarët në lidhje me shërbimet publike, duek lehtësuar dhe mbështetur pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqëri, pavarësisht nga niveli i të ardhurave, gjinia, mosha, aftësia e kufizuar, përkatësia etnike, orientimi seksual, vendbanimi apo besimi fetar”*

■ Objektivat strategjikë

1. Hartimi dhe zbatimi i sistemeve të qendrueshme për përfshirjen sociale përmes:

- 3.7 Vendosijs së Grupit të Treguesëve Statistikorë dhe Integritetit (SIIG) për të garantuar konsistencë me përkufizimin dhe përdorimin e treguesëve, kombinuar me vendosjen e një baze historike treguesish (2010-2015) dhe garantimin e përputhshmërisë me futjen dhe kalimin në EU SILC;
- 3.8 Përpilimit dhe botimit të një fjalorthi terminologjik për përfshirjen sociale që do të qarkullohet në të gjitha organet publike, think tank-et dhe organizatat jo-qeveritare;
- 3.9 Mbledhjes dhe analizës së vazhdueshme të të dhënave administrative mbi gjininë, përkatësinë etnike dhe aftësinë e kufizuar; dhe
- 3.10 Ngritjes së një Njësie të Burimeve Teknike që ka si objektiv analizimin e përfshirjes sociale dhe varfërisë.

4. Hartimi dhe zbatimi i sistemeve efikasë të qeverisjes së përfshirjes sociale përmes:

- 4.1 Ngritjes së një Grupi Tematik për Përfshirjen sociale që garanton bashkërendimin dhe zbatimin e SIPD-it, si pjesë e Politikave për Punësim, Aftësi Profesionale dhe Politika Sociale (ESSP);
- 4.2 Organizimit të një shqyrtimi institucional të masave për përmirësimin e kompetencave teknike dhe qeverisjes organizative të përfshirjes sociale në Shqipëri; dhe
- 4.3 Hartimit dhe zbatimit të strategjisë së Komunikimit për përfshirjen sociale që merr në konsideratë pushtetin qendror dhe vendor, sektorin privat dhe aktorët e shoqërisë civile.

5. Përmirësimi i dialogut të politikave përmes:

- 5.1 Publikimit të një raporti vjetor mbi përfshirjen sociale në Shqipëri, bazuar mbi sondazhet aktuale dhe të ardhshme, si edhe të dhënat cilësore;
- 5.2 Hartimit dhe zbatimit të sondazheve periodike/tematike cilësore të përfshirjes sociale në Shqipëri të përqëndruara tek intensiteti, shkaqet dhe tipologjia e përjashtimit social; dhe
- 5.3 Krijimit të një dialogu politikash mbi përfshirjen sociale në Shqipëri nëpërmjet aktiviteteve periodike dhe një konference vjetore të përfshirjes sociale.


11.8 Garantimi i Barazisë gjinore

- **Situata aktuale.** Qeveria shqiptare i konsideron të drejtat e grave si pjesë integrale të të drejtave të njeriut, duke synuar eliminimin e diskriminimit gjinor dhe uljen e rasteve të dhunës në familje. Qeveria kërkon të garantojë më tej transpozimin e *acquis* të BE-së për barazinë

gjinore (legjislacioni i BE-së dhe direktivat e zbatuara brenda BE-së) për të siguruar barazinë gjinore.²⁹

Miratimi në vitin 2008 i Ligjit "për barazinë gjinore në shoqëri" solli përcaktimin e kuotës së përfaqësimit të grave në të gjitha institucionet legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe institucione të tjera publike. Pavarësisht arritjeve lidhur me pjesëmarrjen së grave në vendim-marrjen politike gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013, përqindjet e përfaqësimit të grave në pushtetin vendor mbeten në nivele të ulta (7.7% Kryetare Bashkie). Gjithashtu, nëse i referohemi Figurës 48 vërehet tendenca në rritje e përqindjes që kanë patur gratë janë në Parlament gjatë periudhës 2008-2015 duke arritur në 22.1% në vitin 2015. Vlen të theksohet gjithashtu se në vitin 2016, përqindja e grave në nivel drejtues ministrorë është 42% (8 gra kundrejt numrit total 19). Në fushën e arsimit, përqindjet e pjesëmarrjes janë të larta: 53.5% e personave që kishin mbaruar shkollën e mesme ishin femra (2013-14, INSTAT) dhe 63% e mësuesëve në arsimin e mesëm janë femra. (Shih edhe zbërthimin e të dhënave për arsimin, në Seksionin 11.1).

Figura 41. Përqindja e vendeve që kanë pasur gratë në Parlament në 2008-2015



Përsa i takon dhunës në familje, është ngritur mekanizmi i referimit për rastet e dhunës. Ky mekanizëm gjeti shtrirje graduale në 27 bashki duke pasur si synim ofrimin e shpejtë të mbështetjes efikase për të tilla raste në nivel vendor. Në vitin 2014-2015 u zbatua sistemi online i mbledhjes së të dhënave për të monitoruar situatën. Arritja e synimit fuqizimit të plotë ekonomik të grave mbetet një sfidë. Kështu, p.sh. si pjesë e Raportit të Zhvillimit Njerëzor për vitin 2013, Shqipëria renditet në vendin 44 nga 149 vende përsa i takon Indeksit të Pabarazisë Gjinore (indeksi pasqyron pabarazitë gjinore në tri dimensione –shëndeti riprodhues, fuqizimi dhe aktiviteti ekonomik).

Në këtë kuadër, është miratuar Plani i Veprimit për Mbështetjen e Grave Sipërmarrëse 2014-2020 dhe në vitin 2014 u krijua Fondi për Gratë Sipërmarrëse. Kjo fushë mbetet një prej prioritetëve afatgjata të qeverisë, duke marrë në konsideratë barrën e punës së papaguar dhe përgjegjësitë familjare të grave. Kjo situatë ka bërë që gratë të kenë më pak mundësi reale për të marrë pjesë në tregun e punës, për të pasur një biznes apo për të marrë kredi.

²⁹ Udhërrëfyeni i BE-së për Barazinë EU midis grave dhe burrave përshkruan gjashtë fusha prioritare për veprime në lidhje me barazinë gjinore: (1) pavarësi e barabartë midis grave dhe burrave; (2) përputhje e jetës private me atë profesionale; (3) përfaqësim i barabartë në vendim-marrje; (4) zhdukja e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore; (5) Eliminimi i stereotipeve; dhe (6) promovimi i barazisë gjinore për politikën e jashtme dhe zhvillimore. Ref. KE, Dokumenti i konsultimit "Roadmap for equality between women and men 2006-2010 dhe strategjia pasuese, fq 1.

Hartimi i kuadrit strategjik për Barazinë Gjinore 2020 është një nga hapat seriozë i përfshirjes gjinore të Qeverisë së Shqipërisë dhe çështjeve të fuqizimit të grave. Ky kuadër strategjik do të ndërtojë themelet për veprime të mëtejshme për ta zgjeruar mbështetjen e qeverisë për fuqizimin ekonomik të grave, sidomos në fushat e punësimit dhe aftësive të grave dhe sipërmarrjes.

■ **Sfidat.** Sfidat dhe prioritetet kryesore gjatë periudhës së planifikimit 2015-2020 përfshijnë nevojën për: (1) rritjen e përfaqësimit të grave në vendim-marrjen e të gjitha niveleve të qeverisë; (2) dhënien më shumë pushtet ekonomik grave në nivele urbane dhe rurale; (3) garancinë që aspektet gjinore të pasqyrohen në të gjitha politikat; (4) uljen e dhunës në familje; dhe (5) përmirësimin e mekanizmave për promovimin e barazisë gjinore.³⁰

■ **Vizioni.** *“Një shoqëri ku barazia gjinore respektohet, vlerësohet, mësohet, gjen mbështetje dhe inkurajohet dhe ku barazia e mundësive dhe trajtimit është realitet për të gjithë, pavarësisht nga gjinia, ku dhuna me bazë gjinore e çdo forme qoftë nuk tolerohet, por ndëshkohet dhe ku personat që preken prej saj mbështeten dhe mbrohen”*

■ Objektivat strategjikë

1. Nxitja e fuqizimit ekonomik të grave dhe rritja e pavarësisë së tyre ekonomike përmes:

- 1.1 Aplikimit të fondit të posaçëm për nxitjen e sipërmarrjes mes grave, , për një periudhë zbatimi 4 vjeçare;
- 1.2 Rritjes së numrit të grave që marrin kredi nga skemat mbështetëse në sektorin bujqësor; dhe
- 1.3 Miratimit dhe zbatimit të Kuadrit Strategjik për barazinë gjinore për periudhën 2016-2020.

2. Rritja e përfaqësimit të grave në vendim-marrjen politike dhe publike përmes:

- 2.1 Realizimit të kuotës gjinore prej 30% për një përfaqësim të barabartë në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe në institucionet e tjera publike;
- 2.2 Monitorimit vjetor të aplikimit të kuotës së pjesëmarrjes me mbi 30% të grave dhe vajzave në nivelet e larta të vendim-marrjes politike dhe administratës, në sistemin e arsimit, sistemin gjyqësor dhe në të gjitha nivelet e ekonomisë, duke përfshirë sektorin privat dhe shoqërinë civile; dhe
- 2.3 Fuqizimit të kapaciteteve të përgjithshme të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qeveritare, përsa i takon analizës së politikave gjinore, planifikimit, manaxhimit të të dhënave, raportimit dhe monitorimit (këtu përfshihen edhe kapacitetet e Departamentit për Përfshirje sociale dhe Barazi gjinore në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë).

³⁰ Strategjia Kombëtare e *Barazisë gjinore 2016-2020*” që po hartohet aktualisht do të trajtojë të gjithë spektrin e çështjeve gjinore, politikave dhe strategjive për periudhën e planifikimit t SKZHI-II.

3. Fuqizimi i mekanizmave institucionalë dhe juridikë për nxitjen e barazisë gjinore dhe garantimin e të drejtave të njeriut për shtetasit shqiptarë, pavarësisht nga gjinia përmes:

- 3.1 Harmonizimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin ndërkombëtar dhe me *acquis* të BE-së për integrimin e aspektit gjinor dhe zbatimin e buxhetit gjinor;
- 3.2 Monitorimit periodik të zbatimit të legjislacionit dhe strategjisë për barazinë gjinore, mbi bazën e instrumenteve të reformuara statistikore dhe paketave të monitorimit; dhe
- 3.3 Fuqizimit të kapaciteteve për garantimin e qendrueshmërisë së strukturave të punonjësve gjinorë në nivel qendror dhe vendor.

4. Ulja e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje përmes:

- 4.1 Ndërgjegjësimit të vazhdueshëm të publikut të gjerë përmes fushatave që e bëjnë dhunën të papranueshme nga shoqëria, duke përfshirë edhe kontributin e burrave dhe djemve, programet e arsimit publik, median dhe publikimin e materialeve ndërgjegjësuese;
- 4.2 Zgjerimit dhe forcimit të Mekanizmave Kombëtarë të Referimit (MKR) në të gjitha bashkitë e vendit;
- 4.3 Futjes së këshillimit kombëtar pa pagesë online për rastet e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) dhe dhunës në familje (DHF);
- 4.4 Forcimit të kapaciteteve të administratës publike (në arsim, shëndetësi, polici, drejtësi) në lidhje me çështje të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje; dhe
- 4.5 Forcimit të rolit të shoqërisë civile për mbështetjen e aspekteve gjinore dhe në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

11.9 Fuqizimi i rinisë

Situata aktuale.

Shqipëria, në krahasim me vendet e tjera evropiane, vazhdon të mbetet një vend me moshë mesatare të re, ku rreth 30% e popullatës dominohet nga mosha 15-29 vjeç, duke përbërë grupimin më të madh të forcës aktive në shoqëri dhe forcës së aftë për punë.

Edhe pse të rinjtë kanë qenë vazhdimisht në vëmendjen e qeverive shqiptare, përsëri ata përballen me sfida të ndryshme, të tilla si përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse dhe proceset demokratike, punësimin, edukimin, kujdesin shëndetësor dhe përfshirjen sociale, etj.

Në vitin 2015 u miratua Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë duke pasur si qëllim ndërtimin e platformave rinore për krijimin e hapësirave për zhvillimin e talenteve dhe krijimtarisë. Kjo platformë gjithashtu ka si synim përmirësimin e mekanizmave të punësimit dhe pjesëmarrjes së rinisë në shoqëri, punë vullnetare dhe angazhime sociale.

Sfidat. Sfidat me të cilat përballen rina lidhen me: (1) nevojën për më shumë pushtet ekonomik rinor përmes programeve të nxitjes së punësimit, arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale; (2) nevojën për krijimin e hapësirave publike për t'iu shërbyer të rinjve; (3) fuqizimin e kapaciteteve të organizatave rinore; (4) krijimin e rrjeteve rinore, këshillave të qarqeve dhe

komisioneve kombëtare të konsultimit për çështjet rinore; dhe (5) nevojën për rritjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në komunitet dhe programeve ndër-rajonale.

Vizioni: *“Një rini aktive dhe me barazi në të gjitha fushat e jetës shoqërore, e shëndetshme, e arsimuar dhe me një status të konsoliduar në shoqëri.*

Objektivat strategjikë

1. Mbështetja dhe integrimi i të rinjve në tregun e punës, si punëmarrës dhe sipërmarrës përmes:

- 1.1 Krijimit të Shërbimit Kombëtar Rinor, si një strukturë buxhetore nën Ministrinë përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe aspekteve rinore;
- 1.2 Krijimit të qendrave rajonale rinore, si njësi direkte të shërbimeve rinore;
- 1.3 Ngritja e *“Inkubatorëve të biznesit për rininë”* për rritjen e pjesëmarrjes rinore përmes hapësirave administrative që u sigurojnë sipërmarrësve të rinj hapësirat në zyra dhe objekte të tjera administrative;
- 1.4 Krijimit të Trupave Kombëtare Rinore; dhe
- 1.5 Mbledhjes dhe sigurimit të informacionit për programet që nxisin punësimin e të rinjve.

2. Nxitja dhe thellimi i pjesëmarrjes së të rinjve në shoqëri, vendim-marrje dhe mirëqënie përmes:

- 1.1 Rritjes së ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të kapaciteteve rinore dhe organizatave për programet komunitare;
- 1.2 Mbështetjes së ofruar për mirëqënien rinore, duke u përqëndruar tek nxitja e shëndetit mendor dhe seksual, aktiviteti fizik dhe jeta e shëndetshme;
- 1.3 Nxitjes së pjesëmarrjes së rinisë në organizatat e shoqërisë civile në të gjitha nivelet; dhe
- 1.4 Krijimit dhe nxitjes së programeve të praktikave rinore.

3. Forcimi i arsimit dhe formimit profesional për të rinjtë në të gjitha nivelet dhe shtimi i mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës përmes:

- 3.1 Çertifikimit dhe njohjes së arsimit jo-formal, si pjesë e të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- 3.2 Fushatave të ndërgjegjësimit për arsimin profesional të drejtuar drejt kërkesave të tregjeve të punës; dhe
- 3.3 Ngritjes së zyrave të zhvillimit të karrierës, në shkollat e mesme apo në universitete, me qëllim orientimin e të rinjve drejt kërkesave të tregut të punës.

11.10 Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën

■ **Situata aktuale.** Kultura dhe trashëgimia përbëjnë një prej sektorëve më ndikimin më të fortë në zhvillimin demokratik të vendit dhe riafirmojnë identitetin kulturor në rajon dhe në Evropë. Sektori ka si synim të thellojë dhe zhvillojë më tej industrinë kulturore vendore, si edhe

të mbrojtë, të ruajë dhe të integrojë transmetimin e tërësisë së vlerave kulturore të krijuara nga populli shqiptar në shekuj. Aktualisht po hartohet *Strategjia Kombëtare e Kulturës* (këtu përfshihet edhe arti i trashëgimisë kulturore).

Vlen të përmendet hartimi i kuadrit ligjor themelor për zhvillimin e sektorit, si ligji *“Për artin dhe kulturën”* i miratuar në vitin 2010, si edhe ndryshime të mëvonshme të këtij ligji, që krijuan hapësira për vetë-administrimin e hapësirave për institucionet artistike dhe kulturore, së bashku me një rritje të cilësisë, konkurrencës dhe performancës institucionale.

Shqipëria ka marrë pjesë me sukses në dy programe të BE-së: *“Europe for Citizens”* me 29 organizata dhe bashki fituese nga Shqipëria (3 si drejtuese) dhe *“Culture 2007 – 2013”* ku fituan 9 projekte shqiptare.

Megjithatë, sfida mbeten: (1) rritja e rehabilitimit të trashëgimisë arkitektonike dhe panoramike; (2) përmirësimi i standardeve dhe cilësisë së shërbimeve që ofrohen në parqet kombëtare arkeologjike (3) përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve muzeale për vizitorët, (4) përmirësimi dhe rritja e produkteve kulturore dhe turistike që ofrohen nga parqet dhe muzeumet.

■ **Sfidat.** Sfida kryesore e sektorit është t’i japë më shumë përparësi produkteve kulturore, si pjesë e programit social, ekonomik dhe zhvillimor brenda vendit, si edhe promovimit të vlerave shqiptare jashtë saj. Me qëllim rritjen e rolit dhe aksesit të publikut të gjerë në art, promovimin e vlerave shpirtërore dhe trashëgimisë kulturore brenda territorit shqiptar dhe dixhitalizimin e trashëgimisë së prekshme dhe jo artistike dhe kulturore kërkohet një qeverisje më efikase dhe eficiente për përmirësimin e produkteve kulturore.

■ **Vizioni.** *“Artet dhe trashëgimia kulturore, si forcë shtytëse për zhvillimin e qendrueshëm ekonomik-shoqëror të vendit”*

■ Objektivat strategjike

1. **Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit nga i cili do të përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe kulturore dhe trashëgimia kulturore përmes:**
 - 1.1 Krijimit të një kuadri ligjor më efikas për mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e arteve dhe trashëgimisë kulturore;
 - 1.2 Përfundimit dhe miratimit të *“Strategjisë Kombëtare për Kulturën”*;
 - 1.3 Krijimit të hapësirave të vetë-administrimit me qëllim rritjen e transparencës, akordimit të fondeve dhe konkurrencës;
 - 1.4 Harmonizimit të kompetencave dhe funksioneve të institucioneve qendrore, këshillave kombëtare të sistemit të trashëgimisë materiale kulturore, institucioneve vendore dhe grupeve të interesit aktive në këtë fushë; dhe
 - 1.5 Uljes së piraterisë në rastet e të drejtave të autorit.

2. **Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jo-materiale kulturore, si pasuri kombëtare për brezat e ardhshëm të Shqipërisë, deri në vitin 2020 përmes:**
 - 2.1 Rehabilitimit të integruar të trashëgimisë së prekshme (qendrat historike, ansamblet, monumentet e kulturës, parqet dhe zonat arkeologjike) dhe transformimin e tyre në qendra të hapura për vizitorët, duke synuar rritje të hapësirave të rehabilituara;
 - 2.2 Përmirësimit të standardeve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara në Parkun Arkeologjik Kombëtar dhe në muzeumet kombëtare, me synim rritjen e ndërhyrjeve rehabilituese dhe rritjes së ofertave turistike;
 - 2.3 Nxitjes së trashëgimisë së prekshme dhe jo të prekshme jo-materiale kulturore përmes rritjes së numrit të veprimtarive; dhe
 - 2.4 Rritjeje e kontributit të industrive kreative

3. **Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptarë dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike, përmes:**
 - 3.1 Arritjes së një rritjeje vjetore në mbështetje të potencialit krijues, në veçanti për artistët e rinj;
 - 3.2 Synimi për rritjeje vjetore të financimeve publike për artin dhe kulturën; dhe
 - 3.3 Dixhitalizimit dhe përpilimit i katalogëve dhe publikimeve për tu arkivuar në arkivën e trashëgimisë kulturore.

4. **Nxitja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe shpirtërore) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave më të mira në skenat shqiptare me qëllim shtimin e aktiviteteve me 30% përmes:**
 - 4.1 Organizimit të ditëve shpirtërore/kulturore kushtuar njohjes dhe promovimit të kulturave përkatëse mes vendeve të rajonit dhe më gjerë, me synim një rritje vjetore prej 8% të numrit të aktiviteteve;
 - 4.2 Rritje e synuar në përfaqësimin dhe mbështetjen e artistëve dhe institucioneve kulturore dhe të trashëgimisë në veprimtari ndërkombëtare; dhe
 - 4.3 Rritjes së prezencës shqiptare në programet kulturore komunitare dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

5. **Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit para-universitar përmes:**
 - 5.1 Hartimit të një Strategjie Kombëtare të Arsimit dhe kalendarëve specifikë artistikë dhe kalendarëve specifikë për çdo institucion të artit dhe trashëgimisë kulturore;
 - 5.2 Një numri më të madh shkollash dhe institucioneve të tjera të përfshira në veprimtari edukative dhe ndërgjegjësimi; dhe
 - 5.3 Rishikimit të kurikulës së sistemit para-universitar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.

11.11 Forcimi i rolit të sporteve

■ **Situata aktuale.** Në Shqipëri, ashtu si edhe në pjesën më të madhe të vendeve, sportet shihen si veprimtari të rëndësishme zhvillimore, shpesh si pjesë e kurikulës zyrtare (si pjesë e edukimit fizik). Në Shqipëri, megjithatë, pak vëmendje formale apo institucionale i është kushtuar niveleve para-universitare dhe universitare, apo formulimit të zgjidhjeve juridike, teknike dhe administrative. Zbatimi i ligjit “Për sportet”³¹ ka qenë problematik për shkak se autonomia dhe vetë-administrimi i strukturave sportive kanë qenë objekt i ndërhyrjeve politike, shpesh përsa i përket emërimit dhe manaxhimit të institucioneve që kanë lidhje me sportin. Kjo ka sjellë mungesa efïçience dhe dobësimin e kapaciteteve institucionale.

■ **Sfidat.** Sfidat kryesore që dalin sot përballë sektorit të sporteve për periudhën 2015-2020 përfshijnë: (1) nevojën për rritjen e autonomisë dhe vetë-administrimit të organizatave sportive kombëtare dhe vendore; (2) nevojën për rritjen e përqëndrimit në nivel edukativ për vlerësimin e sporteve si mjet efikas për fuqizimin e kapaciteteve njerëzore dhe komunitare dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre; (3) rehabilitimin dhe ndërtimin e infrastrukturës sportive; dhe (4) nevojën për ristrukturimin e financimit të përgjithshëm të sistemit kombëtar të sporteve.

■ **Vizioni.** *“Shqipëria- ku qytetarët kanë të drejtën për të ushtruar sportet në përputhje me Kartën Evropiane të Sporteve dhe rekomandimet e organizatave botërore sportive dhe ku të gjithë qytetarët kanë mundësi të barabarta për pjesëmarrje në aktivitetet sportive”*

■ Objektivat strategjikë

1. Rritja e autonomisë dhe vetë-administrimit të organizatave kombëtare dhe vendore përmes:

- 1.1 Reformës së Këshillit Kombëtar të Sporteve dhe komiteteve të tij për tu garantuar bërjen e tyre funksionale, për të qenë apolitike dhe të orientuara drejt partneritetit ndër-institucional;
- 1.2 Përkufizimit të qartë të kompetencave të aktorëve sportivë (federatës, shoqatave dhe klubeve), me qëllim rritjen e autonomisë dhe forcimit të demokracisë së brendshme;
- 1.3 Hartimit të një pakete ligjore për sportet, me qëllim privatizimin e klubeve sportive, mbështetjen e sporteve elitare, përcaktimin e sporteve amatore dhe profesioniste dhe marrjen e masave për parandalimin e dhunës sportive, si objektivi parësor i të gjithë institucioneve;
- 1.4 Reformës së Agjencisë së Shërbimeve Sportive në një Qendër Kombëtare të Sporteve, me qëllim rritjen e cilësisë së sporteve elitare dhe përmirësimin e kushteve të trainimit dhe jetesës së sportistëve, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- 1.5 Rritjes së numrit të testeve anti-doping në 30 teste në vit; dhe
- 1.6 Hartimit të një programi për trainimin e burimeve njerëzore për manaxherë, mjek sportiv, trenerë dhe specialistë.

³¹ Ligji për sportet është miratuar me VKM nr.1720 datë 29 tetor 2008 “Për kriteret që përcaktojnë sportin e niveleve të larta, metodën e shpërblimit të atletëve që i përmbushin këto nivele dhe trajtimin për të përfituar nga sportet përgatitore.

- 2. Fuqizimi i edukimit përmes sporteve për të kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm njerëzor dhe komunitar përmes:**
 - 2.1 Përfshirjes në vlerësimin e aftësive bazë psiko-motorike në kurikulat standarde për fëmijët e moshës 3-6 vjeç;
 - 2.2 Rishikimit të programeve të edukimit fizik, si pjesë e kurikulës bërthamë;
 - 2.3 Ri-organizimit të sporteve brenda dhe jashtë kurikulave shkollore përmes ngritjes së Federatës së sporteve shkollore dhe universitare, si institucion koordinator; dhe
 - 2.4 Përmirësimit të cilësisë së udhëzimeve/instrukcioneve sportive në sistemin arsimit para-universitar përmes trainimit, përmirësimit të bazës didaktike për një shëndet më të mirë të studentëve dhe përmes zbulimit të talenteve dhe nxitjes së sporteve elitare.

- 3. Përmirësimi i infrastrukturës sportive dhe nivelit të pjesëmarrjes së shqiptarëve në veprimtaritë sportive përmes:**
 - 3.1 Zgjerimit të objekteve të brendshme dhe të jashtme sportive, në përputhje me normat e BE-ë;
 - 3.2 Ngritjes së dy qendrave Kombëtare Sportive për trainimin modern të atletëve;
 - 3.3 Rritjes së përfaqësimit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare p.sh. në Tiranë – ish klubi sportiv Dinamo, në Korçë – tek stadiumi “Skënderbeu”); dhe
 - 3.4 Rindërtimit dhe ndërtimit të objekteve sportive nëpër shkolla.

- 4. Krijimi i një skeme funksionale financimi për sistemin kombëtar të sporteve përmes:**
 - 4.1 Rritjes së niveleve të financimit bazë dhe sekondar për sportet përmes llotarive sportive të sponsorizuara nga shteti dhe instrumenteve të tjera; dhe
 - 4.2 Përmirësimeve të kuadrit ligjor për sported dhe financimin e tyre.

